



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
NJESIA E HARTIMIT TE DOKUMENTEVE TE KONKURRIMIT PUBLIK**

**DOKUMENTET STANDARDE TË PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PUBLIK**

**PËR**

**Procedurë me Çelësa në dorë me objekt “Sinjalistika Turistike në Sitet e Trashëgimisë  
Kulturore”**

**Prill 2026**

# I. PROCEDURA E KONKURRIMIT PUBLIK

## A. NJOFTIMI I KONTRATËS

### Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

#### 1.1 Emri dhe adresa e autoritetit Kontraktor

Emri Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit  
Adresa Rr. "Aleksandër Moisiu", nr. 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë  
Tel/Fax +355 4 2223077  
E-mail [info@mtks.gov.al](mailto:info@mtks.gov.al)  
Faqja e Internetit [www.mtks.gov.al](http://www.mtks.gov.al)

#### 1.2 Lloji i autoritetit Kontraktor:

Institucion qëndror	Tjetër
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njësi e qeverisjes vendore	
<input type="checkbox"/>	

### Seksioni 2 Objekti i kontratës


#### 2.1 Lloji i "Kontratave Publike për Punë"

Shërbime	Mallra	Punë
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

#### 2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi / vlera e përafërt e kontratës **22,597,120** (njëzet e dy milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekë pa TVSH .
2. Në rastin kur objekti i konkurrimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është** \_\_\_\_\_
3. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit
4. Objekti i kontratës: "Sinjalistika Turistike në Sitet e Trashëgimisë Kulturore".

#### 2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:



Kohëzgjatja 90 (nëntëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e kontratës ose  
DUKE FILLUAR NGA □□/□□/□□□□ ME PËRFUNDIM NË □□/□□/□□□□

## 2. 4 Vendi i kryerjes së punimeve:

Nr.	Sitet	Adresa	Kategoria
1	Kalaja e Lezhës	Lezhë	Kategoria e I-rë
2	Kalaja e Gjirokastrës	Gjirokastrë	Kategoria e I-rë
3	Parku Arkeologjik Antigone	Saraqinisht, Gjirokastrë	Kategoria e I-rë
4	Kalaja e Porto Palermos	Himarë, Vlorë	Kategoria e I-rë
5	Manastiri i 40 – Shënjtoreve	Gjashtë, Sarandë	Kategoria e I-rë
6	Kalaja e Himarës	Himarë, Vlorë	Kategoria e I-rë
7	Parku Arkeologjik Finiq	Finiq, Delvinë	Kategoria e I-rë
8	Parku Arkeologjik Amantia	Ploçë, Sevaster, Vlorë	Kategoria e I-rë
9	Kalaja e Prezës	Prezë, Tiranë	Kategoria e I-rë
10	Kalaja e Krujës	Krujë	Kategoria e I-rë

Subjektet konkurruese lejohen të vizitojnë dhe këqyrin objektet duke ndërmarrë kostot dhe rrisqet e vizitës.

## Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

### 3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës 9

**3.2 Sigurimi i Ofertës:** Operatori Ekonomik Konkurrues paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, sipas Shtojcës 5. Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës së fondit / vlerës së fondit limit, të përcaktuar në dokumentet e procedurës së konkurrimit publik **451,942.4** (katërqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e dy pikë katër) lekë.

## Seksioni 4. Procedura

### 4.1 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

X Oferta me vlerën më të ulët ekonomike



**4.2 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: 22.04.2026 Ora: 10:00

Vendi: Ministria e Kulturës, Adresa Rr. “Aleksandër Moisiu”, nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë.

**4.3 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 120 ditë**

**4.4 Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe shprehjes së interesit:**

Shqip  Anglisht   
Tjetër \_\_\_\_\_

**Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: 07.04.2026**

**B. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKE OFERTUES**

**Seksioni 1. Hartimi i kërkesës/ofertës**

- 1.1 Kandidatët/Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin kërkesën/ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DSPK. Kërkesat/Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DSPK do të refuzohen si të papranueshme.
- 1.2 Kandidatët/Ofertuesit përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 1.3 Originali i kërkesës/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertes duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertes, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesë/ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.
- 1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së konkurrimit.

**Seksioni 2. Paraqitja e ofertës**

- 2.1 Gjuha e ofertës duhet të jetë: shqip / i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i njësuar me origjinalin nga noteri.
- 2.2 Konkurrentët paraqesin vetëm 1 (një) zarf me dokumente të cilët duhet të jenë origjinale ose

kopje të noterizuara të tyre në përputhje me kërkesat për kualifikim dhe vlerësim të kërkuara nga insitucioni që zhvillon konkurrimin publik.

2.3. Zarf i dokumenteve duhet të jetë i mbyllur, i vulosur dhe mbi të duhet të jenë të shkruara:

**“Ofertë publike për procedurën me objekt “Sinjalistika Turistike në Sitet e Trashëgimisë Kulturore”.**

Për: Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Adresa: Rruga “Aleksandër Moisiu” nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë.

*(Emrin e institucionit dhe adresën)*

Emri i subjektit ofertues \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Telefoni: \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_

2.4 Formulari i Ofertës, duhet të plotësohet pa gabime dhe korrigjime dhe të nënshkruhet prej përfaqësuesit ligjor të subjektit konkurrues. Oferta ekonomike dorëzohet në një zarf të vecantë nga dokumentat por brenda zarfit të përcaktuar në pikën 2, dhe sipër tij të shkruhen fjalët “Ofertë ekonomike për objektin” **“Sinjalistika Turistike në Sitet e Trashëgimisë Kulturore”.**”.

*(emri i objektit)*

Edhe ky zarf duhet të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga subjekti ofertues.


Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DST, duke përcaktuar punët që do të realizohen, sasinë dhe çmimin e tyre për “kontratat me çelësa në dorë” dhe “çmimet fikse” për kontratat e punimeve me matje.

Kontratat për ndërhyrjet mund të jenë në dy lloje:

- a. me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuar në projekt mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

Në rastin e kontratave me punime me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

- b. me kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.



Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së konkurrimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

2.5 Njësia e Vlerësimit të ofertave korigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike. Për këtë njoftohet Ofertuesi me një njoftim me shkrim/me email mbi çdo korigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë.

Nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim ose në substancën e Ofertës përveçse korigjimit të gabimeve aritmetike.

Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korigjimin e propozuar apo nuk i përgjigjet kërkesës, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës.

Afati për kthimin e përgjigjes mbi sqarimin e kërkuar apo pranimin e korigjimit është brenda 2 ditëve nga njoftimi.

Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korigjohen, si më poshtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat e shprehura në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korigjohet shuma në total,

- nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korigjohet.

Shumat e korigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute e të gjitha korigjimeve janë me shume se +/- 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

2.6 Nëse oferta/ofertat e dorëzuara, rezultojnë anomalisht e ulët në lidhje me punimet e ndërhyrjeve ruajtëse të ofruara, atëherë Njësia e vlerësimit i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë/analizojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës dhe bindës për Njësinë, atëherë Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të refuzojë ofertën.

Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 40 % e fondit limit të përlllogaritur.
- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 50% e mesatares së ofertave të vlefshme.

2.7 Nëse renditet e para më shumë se një ofertë e vlefshme me të njëjtën vlerë, njësia e vlerësimit vendos me short, për ofertën fituese, në praninë e ofertuesve që janë renditur të parët me vlera të njëjta. Vendimi i Njesisë së Vlerësimit është përfundimtar dhe duhet të jetë i argumentuar. Ofertuesve duhet ti caktohet një afat prej jo më pak se 1 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit për t'u praqitur për hedhjen e shortit dhe ky afat nuk duhet të përkohet në ditë pushimi zyrtar. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim nga procedura e konkurrimit.

2.8 Përveç sa parashikohet në Kërkesat për Kualifikim dhe Kriteret për Vlerësim, të dokumenteve standarte të konkurrimit publik (DSKP), Ofertuesi konkurrent duhet të paraqesë bashkë me ofertën edhe:

- a. Sigurimin e Ofertës në masën 2 % të fondit të vënë në dispozicion për punimet për ndërhyrjet ruajtëse të shpallur në njoftimin publik të konkurrimit publik, përkatësisht: në shumën **451,942.4** (katërqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e dy pikë katër) lekë.
- b. Sigurimi i ofertës do të pranohet në format e mëposhtme:  
- garanci bankare ose nga shoqëritë e sigurimit të licencuara në Republikën e Shqipërisë.
- c. Periudha e vlefshmërisë së ofertës do të jetë: **120** ditë nga data e hapjes së Ofertave.
- d. Çmimet të shprehen në monedhën Lekë.

### C. PROCEDURA E HAPJES SË OFERTAVE

1. Hapja e Ofertave do të bëhet nga Njësia e Vlerësimit të Ofertave në datën **22.04.2026, Ora:10:30, në adresën: Rruga “Aleksandër Moisiu” nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, nga institucioni/Autoriteti Kontraktor- Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.**

Procesverbali i hapjes së ofertave firmoset nga të gjithë të pranishmit dhe të gjithë anëtarët e Njesisë së Vlerësimit të Ofertave. Ofertuesit me kërkesë të tyre, kanë të drejtë të pajisen me një kopje të procesverbalit të hapjes së ofertave.

2. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.

Përfaqësuesi me autorizim me shkrim nga ofertuesi, i pranishëm, paraqet Autorizimin dhe një mjet identifikimi, që konfirmon prezencën e tij në datën e hapjes së ofertave.

Në rast të mosparaqitjes së autorizimit dhe të një mjeti identifikues, personi që përfaqëson ofertuesin nuk do të lejohet të marrë pjesë në datën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave.

Megjithatë pas afatit të mësipërm, ofertuesi apo përfaqësuesi i tij, që nuk ka qenë i pranishëm, ka të drejtë të disponojë një kopje të procesverbalit të Njesisë së Vlerësimit të Ofertave në datën e



hapjes së ofertave, kundrejt kërkesës me shkrim drejtuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

3. Përpara hapjes dhe shqyrtimit të ofertave anëtarët e Njesisë së Vlerësimit të Ofertave duhet të deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me pjesëmarrësit në konkurrim.

Për këtë ata nënshkruajnë me përgjegjësi të plotë deklaratën individuale që mban datën e zhvillimit të konkurrimit publik.

### **Ç. KËRKESAT E KUALIFIKIMIT**

1. Me qëllim që një ofertë të kualifikohet si e vlefshme, konkurenti ofertues duhet të paraqesë dokumentat ligjorë e administrativë, në përputhje me pjesën I-rë të Kërkesave për Kualifikim. Mosplotësimi i çdonjërit nga kërkesat e parashikuara në dokumentet standarde të konkurrimit publik, përbën shkak për skualifikim të subjektit konkurrent dhe refuzim të ofertës së paraqitur.

2. Paraqitja e të gjithë dokumenteve ligjorë e administrative në formën, përmbajten dhe afatin e kërkuar, bën të mundur kualifikimin e subjektit

3. Në rast se Njësia e Vlerësimit të Ofertave konstaton se dokumentat e paraqitura janë të rreme apo të falsifikuara, atëherë ai vendos skualifikimin e subjektit ofertues, që ka paraqitur këto dokumente si dhe i kërkon organeve kompetente fillimin e procedimit penal ndaj subjektit.

4. Dokumentat e paraqitur duhet të jenë origjinale ose kopje të noteruara, jo më vonë se tre muaj përpara datës së hapjes së ofertave, shpallur në njoftimin publik.

### **D. KRITERET E VLERËSIMIT**


1. Njësia e vlerësimit të ofertave lexon me zë të lartë në prani të konkurentëve ofertat ekonomike si çmim total, si dhe dokumentacionin ligjor shoqërues.

2. Pas verifikimit të gabimeve aritmetike të ofertave ekonomike, nëse ka të tilla, Njësia bën vlerësimin dhe klasifikimin e tyre sipas rastit në bazë të kriterit për çmimin më të ulët, Vendimin nr. 425, datë 27.5.2020 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore", i ndryshuar, si dhe në dokumentat standarde të konkurrimit publik.

### **DH. SHQYRTIMI ADMINISTRATIV**

1. Subjekti ofertues, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e marrjes dijeni të vendimit, ka të drejtë të ankimojë vendimin mbi vlerësimin e ofertës duke iu drejtuar fillimisht institucionit që zhvillon procedurën e konkurrimit publik.

2. Ankesat mbi procedurën e vlerësimit të ofertave dërgohen tek Titullari i institucionit që zhvillon procedurën e konkurrimit publik. Pas paraqitjes së ankimit, procedura pezullohet dhe titullari i institucionit që zhvillon procedurën, urdhëron ngritjen e një Komisioni, i cili shqyrton ankimin



dhe merr vendim të arsyetuar brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e ankesës.

3. Organi epror që shqyrton ankesat mbi vendimet për mospranim të ankimit, pranimin pjesërisht ose mos kthimin përgjigje brenda afatit për shqyrtimin e ankesës, është Ministria Përgjegjëse për Trashëgiminë Kulturore ose titullari i njësisë së qeverisjes vendore. Me paraqitjen e ankimit te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, procedura mbetet e pezulluar deri në përfundimin e shqyrtimit të tij. **Pas paraqitjes së ankimit, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore urdhëron ngritjen e Komisionit, i cili shqyrton ankimin dhe i propozon ministrit pranimin ose mospranimin e ankimit.** Shqyrtimi i ankimit përfundon brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e ankesës. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, ministri ose përkatësisht titullari i njësisë së qeverisjes vendore, me urdhër, vendos:

- a) të mos pranojë ankimin;
- b) të pranojë pjesërisht ankimin;
- c) të pranojë plotësisht ankimin.

4. Urdhri i Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore ose i titullarit të njësisë së qeverisjes vendore, është përfundimtar dhe kundër tij mund bëhet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon vijimin e procedurës.

## **E. LLOJI I PUNIMEVE PËR NDËRHYRJET RUAJTËSE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

1. Emërtimi i punimeve për ndërhyrjet: **“Sinjalistika në Sitet e Trashëgimisë Kulturore”.**

2. Pasuria Kulturore:

3. Vendndodhja e pasurisë kulturore:

<b>Nr.</b>	<b>Sitet</b>	<b>Adresa</b>	<b>Kategoria</b>
1	Kalaja e Lezhës	Lezhë	Kategoria e I-rë
2	Kalaja e Gjirokastrës	Gjirokastrë	Kategoria e I-rë
3	Parku Arkeologjik Antigone	Saraqinisht, Gjirokastrë	Kategoria e I-rë
4	Kalaja e Porto Palermos	Himarë, Vlorë	Kategoria e I-rë
5	Manastiri i 40 – Shënjtoreve	Gjashtë, Sarandë	Kategoria e I-rë
6	Kalaja e Himarës	Himarë, Vlorë	Kategoria e I-rë
7	Parku Arkeologjik Finiq	Finiq, Delvinë	Kategoria e I-rë
8	Parku Arkeologjik Amantia	Ploçë, Sevaster, Vlorë	Kategoria e I-rë
9	Kalaja e Prezës	Prezë, Tiranë	Kategoria e I-rë
10	Kalaja e Krujës	Krujë	Kategoria e I-rë

- 4 . Skicimet, Planimetritë e objektit, etj: **Pjesë përbërëse e projektit dhe DSKP**
5. Specifikimet teknike të materialeve dhe mjeteve të punës: **Sipas dokumentacionit bashkëlidhur.**
6. Kriteret e ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse dhe pune të tjera në lidhje me to: **sipas termave të referencës bashkëlidhur**
7. Të tjera: pasaportat e objekteve pasuri kulturore Bashkelidhur DSKP

Të bashkëlidhen, të njehsuar me origjinalin, dokumentacioni i lartpërmendur, përkatësisht: aktet e shpalljes/deklarimit të pasurisë kulturore, projekti i miratuar, vendimi i miratimit, termat e referencës, skica, planimetri, etj..

## **Ë. GRAFIKU I REALIZIMIT TË PUNIMEVE PËR NDËRHYRJET RUAJTËSE**

Punimet për ndërhyrjet ruajtëse do të kryhen për 90 dite nga data e lidhjes së kontratës dhe sipas zërave të projektit të miratuar.

Nëse projekti është i hartuar në faza punimesh përcakto fazat. Për çdo fazë hartohet një situacion në përputhje me projektin e miratuar.

1. Faza e parë:
2. Faza e dytë:
3. Faza e tretë, etj.:
4. Inspektimi dhe kontrolli i punimeve (përvec rastit të projektimit)
5. Përfundimi i punimeve dhe dorëzimi i tyre (përvec rastit të projektimit).
6. Të tjera: \_\_\_\_\_

## **F. SHPALLJA E FITUESIT DHE NËNSHKRIMI I KONTRATËS**

Titullari i Autoritetit Kontraktor do të njoftojë ofertuesin Fitues se oferta e tij është pranuar. Lajmërimi do të përmbajë të paktën vlerën totale të kontratës dhe kërkesën për dhënien e sigurimit të kontratës.

Njoftimi i fituesit do të përbëjë fillimin e procesit për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës.

Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me anë të nënshkrimit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve dhe duhet të firmoset nga ofertuesi fitues brenda afatit të përcaktuar të ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit për shpalljen fitues.

Pasi institucioni publik të ketë nënshkruar kontratën me ofertuesin fitues, asnjë ankesë ndaj një veprimi ose neglizhence në proces që ka çuar në atë faze nuk mund të shqyrtohet me anë të një shqyrtimi administrativ.



Nëse ofertuesi Fitues nuk e pranon kontratën, ofertuesit i konfiskohet sigurimi i ofertes.

Nese ofertuesi fitues, brenda afatit kohor të përcaktuar në dokumentat e konkurrimit ose në njoftimin e fituesit, nuk nënshkruan kontratën ose nuk bën sigurimin e kontratës, Autoriteti Kontraktor fillon procedurën për konfiskimin e sigurimit të ofertes, dhe vijon me shpalljen fitues të pjesmarresit i renditur i dyti ne klasifikim, e me radhë. Nëse është kualifikuar vetëm një ofertë e vlefshme, atëherë procedura anulohet.

## G. ANULLIMI I PROCEDURËS

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të anuluar procedurën e konkurrimit publik, në çdo kohë para shpalljes së fituesit, nëpërmjet një vendimi të arsyetuar mbi shkaqet e anulimit të procedurës. Për këtë duhet të bëjë Njoftim në Buletinin e Njoftimeve Publike si edhe në faqen zyrtare të institucionit (Shtojca 14 në dokumentat e konkurrimit).

Pas hapjes së ofertave Autoriteti Kontraktor anulon procedurën ne rastet kur:

- *nuk është paraqitur asnjë ofertë;*
- *nuk është kualifikuar asnjë ofertë e vlefshme;*
- *ofertuesi/ofertuesiti/e kualifikuar tërhiqen para lidhjes së kontratës ose nuk pranojnë të bëjnë sigurimin e kontratës;*
- *për arsye dhe shkaqe që nuk varen nga vullneti i institucionit/autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës.*

## II. KRITERET E PËRGJITHSHME, KRITERET E POSAÇME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT DHE KRITERET E VLERËSIMIT

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME PËR KUALIFIKIM

Kriteret për kualifikimin e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore janë, si më poshtë vijon:

- a) të jetë person fizik/juridik ose organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar;
- b) të ketë përmbushur detyrimet tatimore, pagesën e sigurimeve shoqërore;
- c) të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike;
- ç) të mos jetë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
- d) të mos jetë në ndjekje penale ose i dënuar me një vendim të formës së prerë;
- dh) të ketë përmbushur detyrimet për taksat vendore;
- e) të provojë që ka aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar, që institucioni vlerëson të nevojshme;
- ë) të jetë i licensuar për projektim, zbatim, mbikëqyrje ose kolaudim, në pasuriteë kulturore, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore në varësi të objektit të konkurrimit;
- g) të ketë përvojë të mëparshme deri në masën 50 % të vlerës së fondit limit të procedurës sipas rastit dhe objektit të prokurimit.
- f) Çdo kriter tjetër teknik që provon aftësitë teknike për të realizuar punimet e kërkuara, në bazë të të dhënave të përcaktuara në dokumentacionin për konkurrimin që institucioni i vlerëson të nevojshme.

Këto kritere do të përmbushen me dorëzimin e dokumentacionit si më poshtë:

- a. Certifikatë e regjistrimit e personit fizik/juridik apo vendimin e gjykatës për themelimin/krijimin e organizatës jo fitimprurëse.
- b. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që subjekti i ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore për punonjësit;
- c. Vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkinë përkatëse, që subjekti i ka shlyer detyrimet e taksave vendore;
- d. Dokument që vërteton përmbushjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike;
- ë. Subjekti duhet të jetë i pajisur me licensë për restaurim, të lëshuar nga Ministria e Kulturës. Për këtë duhet të paraqesë kopje të licensës së subjektit dhe të drejtuesit teknik, ose të krijojë bashkëpunim kontraktual me një subjekt të licensuar, për realizimin e kontratës, dhe të paraqesë një kontratë bashkëpunimi.
- g. Subjekti duhet të ketë përvojë të mëparshme në kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse në pasuritë kulturore gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së fondit limit. Për të vërtetuar këtë kriter operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të ngjashme të lidhura me institucione publike apo edhe me subjekte private gjatë tre viteve të fundit, shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës dhe/ose fatura Tatimore.
- e. Vërtetimin e xhiros vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit, të lëshuar nga organet tatimore përgjegjëse;
- f. Sigurimi i ofertës në vlerën 2% të vlerës së fondit limit të procedurës së konkurrimit.

***Kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh” plotësohen me vetdeklarim të ofertuesit. Fituesi i procedurës së konkurrimit publik dorëzon dokumentacionin original ose kopje të njehsuar para lidhjes së kontratës.***

II. Në rastin e bashkimit të subjekteve, njëri prej tyre i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e punimeve që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Secili prej anetareve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kriteret sipas parashikimeve në dokumentet e procedurës së konkurrimit, të listuara më sipër, përkatësisht gjerat “a”, “b”, “c” dhe “ç” ndërsa për kriteret e përcaktuara në gjerat “d”, “dh”, “e”, “ë” kriteret do të plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi i operatorëve sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit.

Për të dokumentuar këtë bashkimi i subjekteve/operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojë kontratën e bashkëpunimit të hartuar para noterit, në të cilën përcaktohet se cili nga subjektet është përfaqësues i bashkimit gjatë procedurës, lidhjes së kontratës dhe zbatimit të saj.

2. Kriteret që provojnë aftësitë teknike e financiare për të realizuar punimet e kërkuara, në bazë të të dhënave të përcaktuara në dokumentacionin për konkurrim, që institucioni i vlerëson të nevojshme. Përkatësisht:

### **III.2. Kriteret të Posaçme të Pranimit/Kualifikimit në zbatim.**

#### **1. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:**

1.1 Operatori ekonomik duhet të zotërojë licencë profesionale të vlefshme, ose të paraqesë marrëveshje bashkëpunimi me subjekt të licencuar, sipas Vendimit Nr. 792, datë 07.10.2020, për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale.

Licenca duhet të përfshijë të paktën një nga nënkategoritë e mëposhtme në zbatim:

- F-Z/A/1 ose N-Z/A/1: Konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike;
- F-Z/A/2 ose N-Z/A/2: Konservim dhe restaurim të ndërtimeve me karakter mbrojtës.

1.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të konkurrimit publik, staf teknik për kryerjen e punimeve në objekt, konkretisht si më poshtë:

#### **- 1 Inxhinier Ndërtimi**

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma, Kontrate Pune, CV, Librezë Pune

1.3 Operatori ekonomik duhet të ketë si pjesë të stafit të tij ose si staf mbështetës (me kontratë pune/kontratë bashkëpunimi) 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë

18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të konkurrimit publik.

*(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*

1.4 Operatori ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punëtorëve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të konkurrimit publik, duhet të jetë jo më pak se 6 (gjashtë) punëtor.

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

1.5 Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

## **2. Kërkesat lidhur me projektimin:**

2.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë stafin teknik për projektim, ose alternativisht të ketë një marrëveshje bashkëpunimi me një shoqëri projektimi, e cila disponon staf teknik të vërtetuar përmes listëpagesave ose kontratave të shërbimit, si më poshtë:

### **1. 1. Ekspert i Trashëgimisë Kulturore**

- Të ketë arsim të lartë në një nga fushat:
  - Arkitekturë
  - Inxhinieri ndërtimi
- Të ketë minimumi 5 vite përvojë pune në projekte të ngjashme
- Të jetë i pajisur me licencë për ndërhyrje në pasuri kulturore, në të paktën një nga kategoritë:
  - P/A/1 – Projektim në konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike
  - P/A/2 – Projektim në konservim dhe restaurim të ndërtimeve me karakter mbrojtës

### **Dokumentacioni i kërkuar:**

- Licencë/licenca përkatëse
- Diplomë
- CV dhe/ose portofol

## 2. Inxhinier Ndërtimi

- Të ketë arsim të lartë në inxhinieri ndërtimi

### Dokumentacioni i kërkuar:

- Diplomë

## 3. Grafik Dizajner / Kurator

- Të ketë arsim në një nga fushat:
  - Dizajn grafik
  - Arte
  - Komunikim vizual
  - Muzeologji
  - Ose fusha të ngjashme
- Minimumi 5 vite përvojë në projekte të ngjashme
- Të ketë eksperiencë në:
  - Zhvillimin e identitetit vizual
  - Materialeve interpretuese për site kulturore/turistike
- Të ketë njohuri mbi:
  - Standardet e lexueshmërisë
  - Përmasat dhe kompozimin vizual të sinjalistikës publike
- Të ketë aftësi krijuese për:
  - Konceptimin e paneleve informuese
  - Hartave
  - Elementëve orientues me koherencë vizuale dhe përmbajtësore

### Dokumentacioni i kërkuar:

- Diplomë
- CV dhe/ose portofol

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.** Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërm, deklaratimet jo të sakta apo të rreme, si dhe dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara janë kusht skualifikues.

Kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për kualifikim, provohen me dorëzimin e deklaratave të ofertuesit (sipas formatit të miratuar në dokumentat e konkurrimit), formularëve të dokumentave të konkurrimit, si dhe dokumentat e ofertuesit, që janë leshuar jo më vonë se 3 muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Dokumentat të jenë origjinale apo kopje të noterizuara, si edhe të përkthyer në gjuhën shqipe në rastin e dokumentave të huaja.

Në çdo rast, Njësia e vlerësimit të ofertave rezervon te drejten të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga ofertuesi.

#### IV. Kriteri për vlerësimin e ofertave

Oferta fituese është oferta e vlefshme e kualifikuar me vlerën më të ulët ekonomike.

Ofertë e vlefshme konsiderohet oferta që ka plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të kualifikimit.

### I.3 SHTOJCAT

Shtojca 1 - FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK

Shtojca 2 - FORMULARI I OFERTËS

Shtojca 3 - PREVENTIVI I OFERTËS EKONOMIKE

Shtojca 4 - FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Shtojca 5 - LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

Shtojca 6 - DEKLARATË MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shtojca 7 - DEKLARATË MBI KONLIKTIN E INTERESAVE

Shtojca 8 - DEKLARATË PËR PARAQITJE OFERTE E PAVARUR

Shtojca 9 - DEKLARATË MBI KRITERET E PËRGJITHSHME

Shtojca 10 - GRAFIKU I REALIZIMIT TË PUNIMEVE PËR NDËRHJRJET RUAJTËSE

Shtojca 11 - TERMAT E REFERENCËS

Shtojca 12 - NJOFTIMI I FITUESIT

Shtojca 13 – FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

Shtojca 14 – FORMULARI I ANKESËS

Shtojca 15 – FORMULARI I NJOFTIMIT TË ANULLIMIT

Shtojce 16 - DEKLARATA E DISPONUESHMËRISË SË MAKINERIVE

Shtojce 17 - FORMULAR VLERËSIMI

Shtojca 1

FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK  
(plotësohet nga institucioni)

1. Institucioni **Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit**, Tiranë njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.

2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit:


Nr.	Sitet	Adresa	Kategoria
1	Kalaja e Lezhës	Lezhë	Kategoria e I-rë
2	Kalaja e Gjirokastrës	Gjirokastrë	Kategoria e I-rë
3	Parku Arkeologjik Antigone	Saraqinisht, Gjirokastrë	Kategoria e I-rë
4	Kalaja e Porto Palermos	Himarë, Vlorë	Kategoria e I-rë
5	Manastiri i 40 – Shënjtorëve	Gjashtë, Sarandë	Kategoria e I-rë
6	Kalaja e Himarës	Himarë, Vlorë	Kategoria e I-rë
7	Parku Arkeologjik Finiq	Finiq, Delvinë	Kategoria e I-rë
8	Parku Arkeologjik Amantia	Ploçë, Sevaster, Vlorë	Kategoria e I-rë
9	Kalaja e Prezës	Prezë, Tiranë	Kategoria e I-rë
10	Kalaja e Krujës	Krujë	Kategoria e I-rë

3. Llojin e punës: Punë, me çelësa në dorë.

4. Fondi limit i procedurës së konkurrimit publik: 22,597,120 (njëzet e dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekë pa t.v.sh.

5. Afati i realizimit të kontratës 90 (nëntëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e kontratës

6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave jo me pak se është 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike, përkatësisht datë **22.04.2026, ora 10:00**, në zyrën e protokollit të institucionit me adresën e sipërcituar. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.




7. Afatin dhe mënyrën për tërheqjen e dokumenteve të konkurrencës publikë: Kandidatët e interesuar mund të tërheqin dokumentet e procedurës së Konkurrencës, nga ora \_\_\_\_ deri \_\_\_\_ pranë zyrës së Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bazë të kërkesës me shkrim dhe kundrejt një çmimi prej \_\_\_\_\_ lekë, nga ora \_\_\_\_\_ deri \_\_\_\_\_.

**Dokumentet e Konkurrencës Publikë mund të shkarkohen në faqen e internetit [www.mtk.gov.al](http://www.mtk.gov.al).**

8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentat standarde, të miratuara për këtë qëllim.

9. Ofertat do të hapen nga Njësia e vlerësimit të ofertave në datën **22.04.2026, ora 10:30** në sallën e mbledhjeve të institucionit, dhe shqyrtohen brenda afatit prej 15 ditësh nga data e hapjes së tyre.

10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.



Shtojca 2

FORMULARI I OFERTËS  
(plotësohet nga ofertuesi)

Për: \_\_\_\_\_

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë  
e \_\_\_\_\_ deklaroj se:

a) Kam egzaminuar DSK të tërhequra pranë institucionit që zhvillon procedurat e konkurrimit publik dhe paraqesim këtë ofertë pa rezervime ose përjashtime për kërkesat ose afatet dhe kushtet e shprehura këtu.

b) Ne ofrojmë realizimin e kontratës me objekt: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ ashtu si specifikohet në

DSKP dhe në përputhje me Grafikon e Realizimit të paraqitur.

c) Çmimi total i ofertës sonë është \_\_\_\_\_ lekë  
(shuma me shifra dhe fjalë, pa TVSH)

d) Oferta jonë do të jetë e vlefshme për periudhën e specifikuar në të dhënat e Formularit të Ofertës. Kjo periudhë nis nga data e fiksuar si afat i fundit për paraqitjen e ofertave. Gjatë kësaj periudhe, kjo ofertë do të mbetet e vlefshme ndaj nesh dhe mund të pranohet në çdo kohë përpara skadimit të asaj periudhe.

e) Nëse oferta jonë pranohet, ne do të japim sigurimin e kontratës në masën 10% të vlerës së ofertës fituese, në shumën prej \_\_\_\_\_ lekë,  
(shuma me shifra dhe fjalë)  
siç kërkohet në DSKP.

f) Ne nuk marrim pjesë si ofertues në më shumë se një ofertë në këtë konkurrim publik.

k) Ne e kuptojmë se ju, institucioni publik, nuk jeni të detyruar të pranoni çdo ofertë që merrni dhe se ju keni të drejtën të anuloni këtë konkurrim pa shpallur asnjë fitues.

\_\_\_\_\_  
(emër dhe mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

Vula:

Në cilësinë e: \_\_\_\_\_


I autorizuar të nënshkruajë ofertën për dhe në emër të: \_\_\_\_\_

*(emri i subjektit)*

Data \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_.



Armas




## PREVENTIVI I OFERTËS EKONOMIKE

TABELA SHOQËRUESE E OFERTËS EKONOMIKE

Nr.	Lloji i punimeve për ndërhyrjet ruajtëse	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1.	Ideim, dizejim, paraqitje ne projekt 3D te detajuar, permasime dhe pergatitje me detaje specifike, per prodhim per tabelat dhe sinjalistikat e projektit ne Sitet e projektit.	Shërbim	1		
2.	Studim i cdo lokacioni në bazë të projektit dhe ndjekje e procesit deri në finalizim Grup pune Ekspertë të fushës, kurator, restaurator,	Shërbim	1		
1	<b>Panel Informues Tip 1-</b> Hartë informuese në hyrje të sitit/kalasë, përmasat 100 x 200 cm; përmban hartën në gjuhën shqipe dhe angleze dhe plane/ vizatime të sitit/kalasë, si edhe një përshkrim të përgjithshëm të sitit - Konstruksion metalik/prerje me laser; plexiglass me distanciator; brandim UV/Adeziv i printuar; themel i betonizuar 50 cm	Copë	10		
2	<b>Tabelë informuese Tip 2 –</b> Rregullore/Lajmërimë ; përmasat 90 x 135 cm; në gjuhën shqipe dhe angleze - Konstruksion metalik/prerje me laser; plexiglass me distanciator; brandim UV/Adeziv i printuar; themel I betonizuar 50 cm	Copë	2		
5	<b>Tabela orientuese Tip 3.a –</b> Tabelë orientuese pas tabelës informuese të hyrjes së kalasë për të orientuar vizitorët në monumentet e ndryshme brenda	Copë	12		

	kalasë 200 x 150 cm për dy drejtime; drejtim në monumenet dhe objektet brenda kalasë. - Shtylla/tub zingato; d=10, lartesi 2m; tabela metalike (70 x35 cm x 2 cope) ; brandim me boje ekologjike/adeziv i laminuar				
6	<b>Tabela orientuese Tip 3.b</b> – Tabelë orientuese pas tabelës informuese të hyrjes së kalasë për të orientuar vizitorët në monumentet e ndryshme brenda kalasë; tabelë drejtuese, përmasat 200 x 80 cm, drejtim në monumenet dhe objektet brenda kalasë. - Shtylla/tub zingato; d=10, lartesi 2m; tabela metalike (70 x35 cm x 1 cope) ; brandim me boje ekologjike/adeziv i laminuar	Copë	17		
7	<b>Tabelë informuese Tip 4</b> – panel informues për monumentet me përmasa 80 x 65x 135 cm që përmban informacion të shoqëruar me planimetri ose fotografi - Konstruksion metalik/prerje me laser; brandim UV/Adeziv i printuar; themel i betonizuar 50 cm	Copë	52		
8	Tabela paralajmëruese - Tabela metalike; brandim me boje ekologjike/adeziv i laminuar	Copë	43		
9	Kosha metalike	Copë	39		
10	Stola me konstruksion metalik dhe dru	Copë	27		
11	Montime ne cdo lokacion, punetore, teknike, logjistike, transport, diete, akomodim, karburant	Shërbim	1		
	<b>Vlera Totale pa tvsh</b>				




	<b>Tvsh</b>				
	<b>Vlera Totale me tvsh</b>				

Vlerës totale të mësipërme do t'i shtohen të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për tatim-taksat, vetëm në momentin e lidhjes së kontratës për kryerjen e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse.

\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, subjekti)

Nënshkrimi,

Vula,



Shtojca 4

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

GARANCI BANKARE / SIGURACION

Nr.....

Data \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Me këtë dokument vërtetojmë se \_\_\_\_\_ ka derdhur

(emri i pjesëmarrësit në konkurrim)

pranë \_\_\_\_\_ shumën prej \_\_\_\_\_

(emri i bankës, adresa)

(shuma në shifra dhe fjalë)

si kusht për sigurimin e ofertës së paraqitur në konkurrimin publik për punimet për ndërhyrjet ruajtëse për \_\_\_\_\_

(emri i objektit të konkurrimin)

\_\_\_\_\_ merr përsipër të kalojë në llogarinë e \_\_\_\_\_

(banka /shoqëria e sigurimit)

\_\_\_\_\_ këtë garanci bankare /siguracion, në rast se:

(emri i institucionit publik)

1. Pjesmarrësi në konkurrim publik tërheq ofertën pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës.
2. Pjesmarrësi në konkurrim publik heq dorë nga lidhja e kontratës, nëse shpallet fitues.
3. Pjesmarrësi në konkurrim publik nuk paraqet sigurimin e kontratës brenda afatit të kërkuar dhe shpallur nga institucioni publik.
4. Oferta refuzohet për veprime të paligjshme të pjesmarrësit në konkurrim publik.

me paraqitjen e kërkesës së parë me shkrim nga ana e institucionit publik, pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të dokumentohet mosplotësimi i një prej kushteve të mësipërme.

Kjo garanci është e vlefshme deri në datën që përmbushet afati 150 ditë nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së ofertës, me te drejte rinovimi me kërkesë të paleve.

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi dhe vula e Bankës/Shoqërisë së Sigurimit

Shtojca 5


LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL  
(plotësohet nga ofertuesi)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DSKP që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet	Afati kohor

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe institucioni publik/Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.





Shtojca 6

DEKLARATË MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE  
(për tu plotesuar nga ofertuesi)

Deklaratë e ofertuesit pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit publik, që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ nga Institucioni publik/Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e \_\_\_\_\_ të personit fizik/juridik \_\_\_\_\_ deklaroj se:



Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e konkurrimit publik dhe e vërtetojmë këtë me dokumenta (nëse kërkohen nga institucioni publik/autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

V ula



Shtojca 7

DEKLARATË MBI KONLIKTIN E INTERESAVE  
(për t'u plotësuar nga ofertuesi)

Deklaratë e ofertuesit pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit publik, që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ nga Institucioni publik/Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit fizik/juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:


Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të VKM nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin fizik/juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
\_\_\_\_\_

Vula



Shtojca 8

## DEKLARATË PËR PARAQITJE OFERTE TE PAVARUR

Ofertuesi pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit publik \_\_\_\_\_

Institucioni \_\_\_\_\_

Data e zhvillimit të konkurrimit publik: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Objekti \_\_\_\_\_

Fond limit: \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në interes të dhe me cilësinë e ofertuesit ose të përfaqësuesit të ofertuesit (ne rastin kur është person i autorizuar me prokurë për të përfaqësuar ofertuesin) \_\_\_\_\_ në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja , nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të ofertuesit (nëse është person i autorizuar nga ofertuesi)
4. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo ofertues tjetër, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim subjektsh, që:
  - a. paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit për konkurrimin Publik, të bërë nga institucioni;
  - b. është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit për konkurrimin Publik
5. Ofertuesi deklaron se ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë ofertues tjetër konkurrent;
6. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 5, të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a. çmimet ;
  - b. metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c. qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d. paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
7. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo punimeve të cilat lidhen me konkurrimin në fjalë.



29

8. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim, nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes të ofertave.

\_\_\_\_\_  
(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

\_\_\_\_\_  
(Titulli sipas pozicionit në punë)

Data \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_



Shtojca 9

## DEKLARATË MBI KRITERET E PËRGJITHSHME

Ofertuesi pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit publik \_\_\_\_\_  
Institicioni \_\_\_\_\_ Dat \_\_\_\_\_  
a e zhvillimit të konkurrimit publik: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_  
Objekti \_\_\_\_\_  
Fond limit: \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në interes të dhe me cilësinë e përfaqësuesit të ofertuesit \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Ofertuesi \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e konkurrimit. (Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”).
- Ofertuesi \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për ndonjë veprë penale apo për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale, me vendim të formës së prerë.
- Personi/at në cilësinë e **anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik**, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
(Emer, atesia, mbiemer, datelindja, vendlindja)

\_\_\_\_\_  
(Emer, atesia, mbiemer, datelindja, vendlindja)

etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë veprë penale;


- Ofertuesi \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi apo likuidimi (statusi aktiv).
- Ofertuesi \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_



## Shtojca 10

### GRAFIKU I REALIZIMIT TË PUNIMEVE PËR NDËRHYRJET RUAJTËSE

Punimet për ndërhyrjet ruajtëse do të kryhen për **90 (nëntëdhjetë)** ditëve nga data e lidhjes së kontratës dhe sipas zërave të projektit të miratuar.

Nëse projekti është i hartuar në faza punimesh përcakto fazat. Për çdo fazë hartohet një situacion në përputhje me projektin e miratuar.

1. Faza e parë:
2. Faza e dytë:
3. Faza e tretë etj.:
4. Inspektimi dhe kontrolli i punimeve (përvec rastit të projektimit)
5. Përfundimi i punimeve dhe dorëzimi i tyre (përvec rastit të projektimit).
6. Të tjera: \_\_\_\_\_

Punimet për ndërhyrjet ruajtëse, që kërkohet:

**SIPAS DOKUMENTACIONIT BASHKËLIDHUR (PROJEKT-IDEJA FILLESTARE, RELACONI, SPECIFIKIMET TEKNIKE)**

Afatet e ekzekutimit: **90 (nëntëdhjetë)** ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës.

**Zbatimi i kontratës do të fillojë pas miratimit të projektit nga institucionet përgjegjëse.**

## Shtojca 11

### TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i punimeve:

## 2. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

### 2.1.Përfitues

Përfitues të këtij projekti do të jenë Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, publiku vendas dhe ai i huaj, si dhe institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

### 2.2.Përshkrimi i autoritetit kontraktor

Autoriteti kontraktor është Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, MTKS, si ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, cila ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit, promovimit të pasurive kulturore në përputhje me dispozitat e ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi.

### 2.3.Sfondi historik

Trashëgimia kulturore përbën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të turizmit kulturor në Shqipëri. Monumente e kulturës që përfaqësojnë pasurinë kulturore të këtij vendi si Kalatë, monumentet e kultit, urat si dhe parqet arkeologjike dhe jo vetëm janë ndër destinacionet më të rëndësishme për vizitorët vendas dhe të huaj, për njohjen nga afër të historisë së trashëgimisë sonë historike. Nisur nga mungesa e një infrastrukture turistike sinjalistaika e munguar në një pjesë të rëndësishme të tyre si pasojë e dëmtimeve apo dhe erozonit të ndodhur nga ndryshimet klimatike, dëmtimet apo dhe mungesa e tyre në disa prej këtyre destinacioneve për të garantuar një përvojë cilësore dhe të qëndrueshme të vizitorëve lind nevoja e rivlerësimit apo dhe përmirësimit të tyre.

Në këto kushte realizimi i një projekti që synon të përmirësojë infrastrukturën turistike duke u përqëndruar te sinjalistika orientuese dhe informuese, interpretimi për target-groupet e ndryshme dhe shtimi i lehtësirave për vizitorët është një nga nevojat emergjente që duhet të ndërmerren si masa për përmirësimin e kushteve edhe për sezonin turistik veror të ardhshëm. Projekti do të përqëndrohet në një numër të për zgjedhur të kalave dhe parqeve arkeologjike nën administrimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgimisë kulturore të evidentuara nga vetë institucionet që administrojnë këto pasuri kulturore të cilat janë reflektuar edhe në PBA e këtij viti.

Referuar sa më lart, sitet që kanë më shumë nevojë për përmirësimin e sinjalistikës turistike janë:

#### 1. **Kalaja e Lezhës në administrim të DRTK Shkodër**

Kalaja e Lezhës një prej monumenteve të vizitueshme për vetë tipologjinë e saj e ndodhur në qytetin

e Lezhës, në një lartësi rreth 186-metrash mbi nivelin e detit ka një sipërfaqe afërsisht 2 hektar. Referuar të dhënave historike, fortifikimi daton që nga antikiteti, me rindërtime gjatë periudhave mesjetare dhe osmane. Arkitektura e kalasë përmban elementë nga periudha të ndryshme, duke përfshirë ndikime bizantine, venedikase dhe osmane. Ajo ka shërbyer si pikë strategjike ushtarake dhe mbrojtëse ndër shekuj. Brenda saj ndodhen struktura të ndryshme, si porta hyrëse, kulla vrojtimi dhe hapësira të tjera ndihmëse. Kalaja ka një rëndësi të madhe historike, pasi lidhet me Besëlidhjen e Lezhës, të mbajtur në vitin 1444 nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Sot, ajo është një monument kulture i kategorisë së parë dhe një destinacion turistik i rëndësishëm, që ofron një pamje të mrekullueshme mbi qytetin e Lezhës dhe rrethinat e tij.

## 2. **Kalaja e Gjirokastrës në administrim të DRTK Gjirokastrë**

Kalaja e Gjirokastrës ose ndryshe Argjiro e njohur si një nga monumentet historike jo vetëm nga popullsia vendase por edhe nga të huajt që lidhet me Festalet Kombëtare Folklorike që ka mbledhur rreth vetes mijera njerëz, artisë, femijë por edhe dashmami të trashëgimisë sonë kulturore një nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore në Shqipëri, ndodhet mbi një kodër në lartësinë 336 metra mbi nivelin e detit. Ajo është një nga kështjellat më të mëdha dhe më mirëruajtura në Shqipëri, me origjinë që daton nga periudha bizantine, por e zgjeruar ndjeshëm gjatë sundimit osman në shekujt XVIII-XIX.

Kalaja shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 2 hektarësh dhe është ndërtuar kryesisht me gurë gëlqerorë të skalitur. Struktura e saj përfshin mure të larta mbrojtëse, kulla vrojtimi, tunele dhe hapësira të brendshme të përdorura si depo, burg dhe ambiente ushtarake. Brenda kalasë ndodhen Muzeu i Armëve, një galeri artilerie me topa të vjetër, si dhe një avion ushtarak amerikan i rrëzuar gjatë Luftës së Ftohtë.

Kalaja e Gjirokastrës ka pasur një funksion të rëndësishëm mbrojtës dhe ushtarak ndër shekuj. Sot, ajo është një monument kulture i rëndësishëm dhe një destinacion turistik kryesor, pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Çdo pesë vjet. Parku Arkeologjik Antigone

Parku Arkeologjik i Antigonesë ndodhet pranë fshatit Saraqinisht, në rrethin e Gjirokastrës. Qyteti u themelua në vitin 295 p.e.s. nga mbreti Pirro i Epirit dhe ka një sipërfaqe prej rreth 90 hektarësh. Rrënojat përfshijnë mure rrethues poligonale, porta hyrëse, rrugë të shtruara, banesa, objekte publike dhe ambiente të shtruara me mozaikë. Antigonea ka pasur një rëndësi të madhe si qendër administrative dhe tregtare në antikitet.

## 3. **Parku Arkeologjik Antigone në administrim të DRTK Gjirokastrë**

Parku Arkeologjik i Antigonesë ndodhet pranë fshatit Saraqinisht, në rrethin e Gjirokastrës. Qyteti u themelua në vitin 295 p.e.s. nga mbreti Pirro i Epirit dhe ka një sipërfaqe prej rreth 90 hektarësh. Rrënojat përfshijnë mure rrethues poligonale, porta hyrëse, rrugë të shtruara, banesa, objekte publike dhe ambiente të shtruara me mozaikë. Antigonea ka pasur një rëndësi të madhe si qendër administrative dhe tregtare në antikitet.

## 4. **Kalaja e Porto Palermos në administrim DRTK Vlorë**

Kalaja e Porto Palermos ndodhet në bregdetin jugor të Shqipërisë, në një gadishull shkëmbor pranë Himarës, dhe përbën një nga fortifikimet më të veçanta të periudhës osmane në vend. Ndërtuar në fillim të shekullit XIX, ajo i atribuohet Ali Pashë Tepelenës dhe shërbente si strukturë ushtarake mbrojtëse për gjirin strategjik të Porto Palermos. Kalaja ka formë planimetricë trekëndore me tre bastione të fuqishme nëpër qoshet. Hyrja ndodhet në mesin e murit jugor.

Kalaja përfshin hapësira të brendshme për qëndrimin e garnizonit, depo armësh dhe ujësjellës të brendshëm, elemente që dëshmojnë funksionin e saj si bazë ushtarake e mirëorganizuar. Sot ajo përbën një nga monumentet më të vizituara të trashëgimisë kulturore bregdetare dhe është e shpallur Monument Kulture i Kategorisë së I-rë.

#### 5. **Manastiri i 40- Shenjtorëve** në administrim të DRTK Vlorë

Manastiri i 40 Shenjtoreve ndodhet në një kodër mbi qytetin e Sarandës dhe përfaqëson një nga monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë paleokristiane në Shqipëri. Ai daton në shekullin VI pas Krishtit dhe është ndërtuar në nder të 40 martirëve të Sebaestes. Manastiri ndodhet mbi kodrën e fshatit Qafë Gjashtë, një pozitë e favorshme për kohën ku kishin mundësi të kontrollonin qytetin e Ankiatit bashkë me portin e tij, gjatë periudhës së Antikitetit të Vonë. Ai përbën një strukturë drejtkëndore me gjatësi rreth 43 m dhe gjerësi 23 m, brendësia e së cilës është organizuar në shtatë konka të barabarta midis tyre, me funksion bazilikë me tre nefë, ambiente ndihmëse, qelira për murgjit dhe sisteme të zhvilluara ujëmbledhëse e nëntokësore.

Pavarësisht dëmtimeve gjatë shekujve, mbetjet e manastirit ruajnë vlera të larta historike, arkitektonike dhe arkeologjike. Manastiri i 40 Shenjtorëve ka status Monument Kulture i Kategorisë së I-rë.

#### 6. **Kalaja e Himarës** në administrim të DRTK Vlorë

Kalaja e Himarës daton që nga antikiteti, me periudha të ndryshme rindërtimi, veçanërisht gjatë mesjetës dhe sundimit venedikas. Kalaja shtrihet në një sipërfaqe të konsiderueshme dhe është ndërtuar kryesisht me gurë gëlqerorë të fortë. Struktura e saj përfshin mure mbrojtëse të trasha, kulla vrojtimi dhe porta hyrëse të fortifikuara. Brenda kalasë ndodhen rrënojat e banesave të vjetra, kisha që datojnë kryesisht në periudhën e mesjetës dhe rrugica të ngushta me karakteristikë arkitekturën tradicionale. Kalaja e Himarës ka pasur një rëndësi strategjike si një qendër mbrojtëse kundër sulmeve osmane dhe një pikë e rëndësishme tregtare në bregdetin e Jonit.

#### 7. **Parku Arkeologjik Finiq** në administrim të DRTK Vlorë

Parku Arkeologjik i Finiqit ndodhet pranë Sarandës dhe përfaqëson një qytet me rëndësi të madhe historike. Kompleksi përfshin teatrin antik, templin, nekropolin dhe rrugët e shtruara, si dhe mbetjet e mureve mbrojtëse. Arkitektura dhe planimetria e qytetit pasqyrojnë zhvillimin urban të periudhës helenistike dhe romake. Parku Arkeologjik i Finiqit është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së I-rë.

#### 8. **Parku Arkeologjik Amantia** në administrim të DRTK Vlorë

Parku Arkeologjik i Amantias ndodhet në rrethin e Vlorës, mbi një kodër në lartësinë rreth 613 metra mbi nivelin e detit. Ai daton që nga shekulli V p.e.s. dhe ka qenë një qytet i rëndësishëm ilir. Struktura më e njohur është stadiumi antik, i cili ka një gjatësi prej rreth 60 metrash dhe përmban mbi 16 radhë shkallësh guri. Përveç stadiumit, në park ndodhen rrënojat e një tempulli antik, portat hyrëse në qytet dhe muret mbrojtëse. Në anën tjetër të parkut ndodhet nekropoli i qytetit me varre monumentale. Amantia ka pasur një rol të rëndësishëm në periudhën ilire dhe romake. Një prej siteve më të rëndësishme me një trashëgimi të pasur Arkeologjike e cila e bën nevojën e një infrastrukture sinjalistike mjaft të nevojshme për vizitorët nisur nga fakti që pozicionimi i saj është lart zonave urbane.

#### 9. **Kalaja e Beratit** në administrim të DRTK Berat

Kalaja e Beratit ndodhet në majën e një kodre shkëmbore në krahun të lumit Osum, në një lartësi rreth 187 metra mbi nivelin e qytetit modern. Fortifikimi aktual përfshin mure rrethuese me gjatësi rreth 1400 metra, të pajisura me 24 kulla mbrojtëse me forma dhe periudha ndërtimi të ndryshme, që datojnë nga Antikiteti i Vonë deri në Mesjetë. Porta kryesore ndodhet në anën jugore dhe është e mbrojtur nga një sistem i përbërë prej kullash dhe kthesash mbrojtëse. Brenda mureve ruhet struktura urbane mesjetare me rrugë gurëshe, banesa karakteristike, si dhe monumente të kultit, përfshirë kishat bizantine dhe xhaminë e kuqe. Kalaja ka pësuar ndërhyrje të shumta ndërtimore gjatë periudhave bizantine, anzhvine dhe osmane, duke ruajtur një shtresëzim historiko-arkitektonik me rëndësi të veçantë për zhvillimin e fortifikimeve në Shqipëri. Nevoja për një infrastrukturës sinjalistike të mirëfilltë shtohet në kushtet që është një prej monumenteve të banuara përmes lagjeve që shtrihen në këtë hapësirë dhe bizneseve të shumta që ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda mureve të saj duke shtuar më shumë interesin por dhe nevojën për ruajtjen e saj.

#### *10. Kalaja e Krujës në administrim të DRTK Tiranë*

Kalaja e Krujës është një monument i trashëgimisë kulturore me vlera historike, arkitektonike dhe simbolike, e zhvilluar kryesisht gjatë mesjetës mbi gjurmë më të hershme antike. Ajo përbëhet nga një sistem fortifikimi me mure rrethuese, kulla mbrojtëse dhe hapësira të brendshme funksionale, të përshtatura sipas terrenit. Kalaja ka luajtur një rol kyç në historinë politike dhe ushtarake të vendit, veçanërisht gjatë shek. XV, dhe sot përfaqëson një qendër të rëndësishme muzeale dhe turistike.

### **3. PËRSHKRIMI I DETYRËS**

#### **3.1. Qëllimi**

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në cilësinë e autoritetit kontraktor do të hartojë projektin “Sinjalistika në sitet e Trashëgimisë Kulturore” me qëllim kryesor rritjen e cilësisë së përvojës së vizitorëve në sitet e trashëgimisë kulturore përmes përmirësimit të infrastrukturës turistike, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor dhe në ruajtjen e vlerave të trashëgimisë.

#### **3.2. Objektivi i përgjithshëm**

Objektivi i përgjithshëm i projektit “Sinjalistika/infrastruktura në sitet e trashëgimisë kulturore” është të rrisë cilësinë e përvojës së vizitorëve, duke siguruar akses të organizuar dhe të sigurt për vizitorët në sitet e trashëgimisë kulturore. Projekti synon të promovojë dhe të ruajë trashëgiminë kulturore, duke zhvilluar infrastrukturën e nevojshme sipas standardeve ndërkombëtare dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor në nivel lokal dhe rajonal. Njëkohësisht, përmes këtij projekti synohet të rritet ndërgjegjësimi i publikut dhe edukimi mbi trashëgiminë kulturore.

Konsulenti do të kryejë të gjitha hulumtimet e nevojshme për të bërë të mundur studimin dhe hartimin e një projekti të zbatueshëm të infrastrukturës turistike në sitet e trashëgimisë kulturore, referuar standarteve ndërkombëtare dhe shqiptare dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

### 3.3.Objektivat specifik

Hartimi i projektit përcakton mënyrat më të qëndrueshme për përmirësimin e eksperiencës së vizitorëve në sitet e trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër, procesi përfshin analizën teknike të gjendjes ekzistuese dhe vendosjen e sinjalistikës turistike dhe interpretative në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Zbatimi i këtyre masave kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e përvojës së vizitorëve, duke mundësuar akses më të lehtë, siguri dhe interpretim të qartë të monumenteve/siteve dhe historisë. Në këtë kuadër, me realizimin e investimeve pritet të rritet vizitueshmëria e siteve kulturore, duke nxitur zhvillimin e turizmit kulturor dhe rritjen ekonomike në nivel lokal dhe kombëtar.

#### 1. Vendosja e sistemit të unifikuar të sinjalistikës turistike dhe interpretimit në terren

Projekti parashikon instalimin e një sistemi të standardizuar të tabelave informuese dhe orientuese, në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare duke theksuar vlerat autentike të trashëgimisë kulturore. Ky sistem do të ndihmojë vizitorët në orientimin në sitet e trashëgimisë kulturore dhe do të ofrojë informacione të strukturuar mbi historinë, funksionin dhe rëndësinë e pasurive kulturore.

#### 2. Përmirësimi i infrastrukturës së qasjes për vizitorët

Ky komponent synon rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës hyrëse brenda dhe rreth zonave të trashëgimisë kulturore. Ndërhyrjet përfshijnë shtimin e rampave dhe hyrjeve, pajisjen me stola qëndrimi, kosha dhe struktura mbështetese me qëllim lehtësimin e qarkullimit të vizitorëve dhe garantimin e një përvoje të sigurt, të aksesueshme gjatë vizitës.

### 3.4.Pritshmëritë

Investimi synon të arrijë pritshmëritë si më poshtë:


- Vendosja e elementeve orientuese dhe informuese
- Respektimi i vlerave historike, arkitektonike dhe mjedisore të siteve;
- Rritja e sigurisë dhe funksionalitetit të hapësirave për vizitorët;
- Vendosja e elementëve ndihmës për vizitorët, si kosha, stola, barriera mbrojtëse etj.
- Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit kulturor;
- Promovimi i trashëgimisë kulturore nëpërmjet përmirësimit të sinjalistikës

### 3.5.Statusi juridik dhe gjendja aktuale

#### **Gjendja ekzistuese**

Pasuritë kulturore, të cilat do të jenë pjesë e projektit kanë nevojë për përmirësimin e infrastrukturës turistike. Në kalatë dhe parqet arkeologjike shpesh hasen problematika në lidhje me tabelat informuese dhe sinjalistën drejtuese, duke mos i orientuar vizitorët brenda sitit. Gjithashtu, një ndër problematikat e tjera lidhet me interpretimin e trashëgimisë kulturore dhe përfshirjen e target grupeve të ndryshme të vizitorëve.

Të gjitha pasuritë kulturore, pjesë e projektit janë aktualisht pronë shtet dhe përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore (MTKS).



37

### 3.6. Bashkëpunimi me të Tretët / Palët e Interesit

Konsulenti është i detyruar të bashkëpunojë ngushtë me stafin e autoritetit kontraktor, me strukturat e pushtetit vendor, me institucione shtetërore si, Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, si dhe me subjekte të tjera që paraqesin interes në raport me këto objekte.

Grupe të tjera të interesit:

- IKRTK
- Qendra Muzeore Durrës
- Agjencia Kombëtare e Turizmit
- Agjencitë Rajonale të Turizmit
- Agjenci dhe Guida Turistike
- Komunitetet Lokale
- Turistët, Vizitorët
- Sponsorët
- Donatorët

### 3.7. Baza ligjore

Ndërhyrjet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi si:

- Ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
- VKM 1125; datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”
- VKM 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore.”
- VKM Nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”.

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektimin dhe zbatimin që parashikon legjislacioni në fuqi. Zbatimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e zbatuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave.

## 4. SHËRBIMET E KËRKUARA DHE PARAQITJA E DOKUMENTACIONIT

- **Përgatitja e projekt-idesë dhe specifikimeve teknike** – përfshin dokumentacionin teknik dhe grafik të projektit të detajuar, duke përfshirë specifikimet e materialeve, pozicionimin e çdo elementi në hartë, detajet teknike lidhur dhe mënyrën e mbështetjes në tokë dhe thellësisë së inkasimit apo edhe mënyrën e inkasimit në muraturë në rast se do të propozohet në projekt, modelet në përputhje me standardet e duhura për secilin sit të përzgjedhur në kuadër të sinjalistikës turistike të propozuar.



38

- **Hartimi i kostove/ preventivat paraprake** – synon hartimin e përllogaritjes së kostove të parashikuara për çdo element infrastrukture, në përputhje me standardet teknike të legjislacionit në fuqi.

- **Hartimi i planeve në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e punimeve të infrastrukturës turistike në sitet e përgjdhura** – përfshin përgatitjen e udhëzimeve dhe protokolleve mbi inspektimin dhe mirëmbajtjen me qëllim ruajtjen e cilësisë së ndërhyrjeve.

- **Përgatitja e dokumentacionit të tenderimit për zbatimin e projektit** – konsiston në përgatitjen e dokumentacionit të plotë të tenderimit, përfshirë projektin teknik, specifikimet, preventivin.

- **Mbikëqyrja teknike gjatë fazës së zbatimit** – përfshin asistencën profesionale për garantimin e zbatimit të projektit sipas standardeve të miratuara dhe në përputhje me kërkesat e trashëgimisë kulturore.

Drejtorja përkatëse do të vlerësojë dokumentacionin mbi bazën e plotësisë teknike, cilësisë së propozimeve dhe përputhshmërisë me objektivat e projektit.

**Dorëzimi: Konsulenti pritet të paraqesë dorëzimet e mëposhtme:**

Projekt-ideja dhe specifikimet teknike, e cila do të përmbajë dhe përmbajtjen e secilës tabelë në dy gjuhë, shqip dhe anglisht;

Preventivi i kostove

Grafiku i Punimeve për furnizim vendosjen e infrastrukturës turistike

Plani i funksionalitetit dhe mirëmbajtjes

Për të gjithë dokumentacionin në pikat e mësipërme, duhet të realizohen:

**Projekt Arkitektonik**

Format A3: arkitektonik, konstruktiv

Në projektin arkitektonik do të përfshihen të gjitha modelet e tabelave, dimensionet, përmbajtjen si dhe të gjithë elementët e tjerë të infrastrukturës turistike, të përmendura tek pritshmëritë.

**Relacioni arkitektonik**

Formati A4: arkitektonik, konstruktiv

**Grafiku i punimeve**

Struktura e detajuar e grafikut të punimeve të zbatimit

**Preventivi i punimeve**

Preventivi i ndërhyrjeve duhet të jetë i hartuar në përputhje me manualin në fuqi dhe të jetë i hartuar i ndarë në kapituj bazuar në proceset e punës që do të planifikohen. Zërat e ndërhyrjeve duhet të jenë në përputhje me proceset e parashikuara në projektet teknike si edhe specifikimet teknike dhe t'i përmbahen atyre me korrektësi.

**Specifikimet teknike:**

Kontraktuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin prej materialeve që do të përdoren. Për çdo zë të përfshirë në preventiv, duhet të ndiqet:

- Përshkrimi i detajuar i artikullit të punës;
- Mënyra e vendosjes;
- Cilësia e kërkuar;
- Formatet e Lejuara;
- Ngjyra e rekomanduar;
- Skica, vizatime ose fotografi.

**Dorëzohet:** Konsulenti do të dorëzojë paketat e punëve bazuar në këto Terma Reference, dhe secila paketë e punimeve do të përfshijë për secilin projekt investimi: (i) dokumentacionin e detajuar të projektimit përfshirë vizatimet e gen planit të sitit me pozicionimin e çdo sinjalistike dhe elementëve ndihmës (kosha/stola), planeve / prerjeve tërthore / pamje 3D / detaje teknike / specifikimet teknike bazuar në sondazhet teknike dhe duke përdorur standardet dhe praktikën më të mira të projektimit; (ii) specifikimet teknike përfundimtare; (iii) raportet teknike përfundimtare (iv) preventivat përfundimtarë dhe (v) vlerësimet përfundimtare të ndikimit mjedisor dhe social. Konsulenti do të vijojë me aplikimin në sistemin online E-lejet të projektit të detajuar të Projekt-Idesë dhe Projektit të Zbatimit sipas dokumentacionit të përcaktuar më sipër. Projekti do të vijojë me shqyrtimin dhe miratimin në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

#### **DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT, AFATET DHE MIRATIMET**

Lista e mëposhtme përfshin dorëzimet që kërkohen nga Konsulenti për secilën paketë projekti, afatet për dorëzim dhe afatet për miratim nga organet kompetente. Kjo listë shërben si një udhëzues për konsulencën. Konsulenti pritet të propozojë një plan pune që përshkruan nën-detyrat e projektit (p.sh. seanca shpesh për konsultim të brendshëm me përfaqësues të Autoritetit Kontraktor) për të përmbushur objektivat e detyrës në mënyrë efektive.

*Tabela e Dorëzimeve:*

Raportet	Gjuha	Data e dorëzimit	Numri i kopjeve	
			Report	CD
Projekt Ideja Paraprake e cila do të përfshijë: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Design Paraprak Tabelash dhe përmbajtja për cdo sit;</li> <li>▪ Design Paraprak të Elementëve të Infrastrukturës Turistike</li> </ul>	AL	21 ditë	Fizikisht 3 kopje në MTKS	2
Miratim në KKTKM të Projekt Idesë Paraprake		7 ditë		
Projekt Zbatimi i Detajuar shoqëruar me relacionet i cili do të përfshijë : <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dizajn përfundimtar të Tabelave dhe përmbajtjen</li> </ul>	AL	20 ditë	Fizikisht 3 kopje në MTKS	2

<ul style="list-style-type: none"> <li>Dizajn përfundimtar të elementevë të infrastrukturës duke përfshirë pozicionimin e çdo elementi në hartë, detajet teknike lidhur edhe mënyrën e mbështetjes në tokë dhe thellësisë së inkasimit, apo edhe inkasimit në muratë në rast se do të propozohet në projekt.</li> </ul>				
Miratim në KKTKM të Projektit të Zbatimit		7 ditë		
Prodhimi i tabelave dhe infrastrukturës turistike dhe montimi ne sitet e përzgjedhura	AL	35 ditë	Relacion përfundimtar i prodhimit dhe montimit të elementëve nga Operatori Ekonomik 3 Kopje	2
Total		90 ditë		

## 5. PROFILI I EKSPERTËVE / EKSPERTIZA E NEVOJSHME

### 5.1.Kompetencat e nevojshme

Autoriteti kontraktor fton partneritete shqiptare - ndërkombëtare, sipërmarrje të përbashkëta ose konsorciume që mund të demonstrojnë, përmes ekipit të tyre të propozuar, të paktën 5 vjet përvojë të suksesshme në secilën nga fushat më poshtë:

1. Trashëgimi Kulturore
2. Inxhinier
3. Dizainer Grafik/ Kurator

## 6. KOHËZGJATJA DHE DORËZIMET

### 6.1.Data e fillimit

Data e fillimit për përgatitjen e shërbimeve parashikohet të jetë pas hyrjes në fuqi të kontratës. Kohëzgjatja e projektit parashikohet për \_\_muaj, me draftet dhe prezantimet për matricën e dorëzueshme të projektit të paraqitur më parë.

*Sqarim: Data e fillimit të shërbimit do të jetë në varësi të përfundimit të lidhjes së kontratës.*

### 6.2.Përmbajtja dhe numri i kopjeve

Konsulenti Operatori ekonomik do të përgatisë dhe dorëzojë në rrugë zyrtare tek Autoriteti Kontraktor projektin e plotë të zbatimit (sipas listës së vizatimeve më sipër) së bashku me Raportin Përfundimtar, Specifikimet teknike dhe Preventivin përfundimtar.

Projekti do të dorëzohet në formë të shkruar në 3 (dy) kopje të firmosura në origjinal. Raportet do të dorëzohen në format A4. Projekti i Zbatimit do të dorëzohet gjithashtu në dy kopje elektronike (në disk) në formatin origjinal të punuar, kompatibël me programet AutoCad, GIS, Adobe, etj.

Projekti do të aplikohet në sistemin online E-lejet nga konsulenti. Operatori Ekonomik.

Në mënyrë elektronike (të editueshme) do të dorëzohen edhe raportet, preventive dhe specifikimet teknike. Ato duhet të jenë në formatin origjinal të punuar si edhe në formatin PDF. Një kopje elektronike (CD) do të jetë për autoritetin kontraktor dhe një kopje elektronike (CD).

### 6.3.Gjuha

Gjuha e projektit “Sinjalistika/Infrastruktura Turistike në Sitet e Trashëgimisë Kulturore” do të jetë në gjuhën shqipe.

### 6.4.Parashikimi i datës së përfundimit ose kohëzgjatja

Afati i dorëzimit është parashikuar brenda datës \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_.

Duhet të theksohet se data e fillimit, datat e dorëzimeve për raportet që duhet të dorëzohen dhe kohëzgjatja totale e detyrës, janë të llogaritura si ditë kalendarike.

Vendi dhe dorëzimi i punimeve: sipas siteve të percaktuara në termat e referencës.

Shtojca 12

NJOFTIMI I FITUESIT

Data:

Emri i institucionit: \_\_\_\_\_

Emri i subjektit fitues: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ lajmëron \_\_\_\_\_  
(Emri i institucionit)(emri dhe adresa e subjektit Fitues)

se Oferta e paraqitur më datë \_\_\_\_\_ për kryerjen e punimeve për ndërhyrjet  
ruajtëse të objektit \_\_\_\_\_ për shumën totale  
prej \_\_\_\_\_  
(emri dhe përshkrim i përgjithshëm i restaurimeve)

\_\_\_\_\_ Lekë është pranuar.  
(shuma në shifra dhe fjalë)

Subjekti fitues \_\_\_\_\_ kërkohet t'i paraqesë \_\_\_\_\_  
(emri i institucionit)

Sigurimin e Kontratës të përcaktuar në Dokumentet e Konkurrimit Publik, brenda  
datës \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_.

Në rast se terhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim brenda datës së mësipërme  
dhe sigurimi i ofertës së konkurrimit publik kalon për llogari të  
institucionit \_\_\_\_\_.  
(emri i institucionit)

.....  
Drejtuesi i institucionit  
(emri, firma dhe vula)

Shtojca 13

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

GARANCI BANKARE/ SIGURACION

Nr. \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

Për: \_\_\_\_\_

*Emri dhe Adresa e Institucionit publik*

- Duke qenë se \_\_\_\_\_ është shpallur fitues për  
(emri i kontraktorit)

lidhjen e kontratës me objekt \_\_\_\_\_  
(pershkrim i shkurtër i objektit të kontratës)

- Duke qenë se në kushtet e lidhjes së kontratës kërkohet Garanci Bankare/ Sigurim në shumën e specifikuar në të, si sigurim perpermbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë:

- Duke qenë se \_\_\_\_\_ është dakord të leshojë këtë  
(emri i bankës/shoqërisë së sigurimit)

garanci në masën 10% të vlerës së ofertës së shpallur fituese;

Deklarojmë se ne jemi garantuesit e kontratës së mësipërme deri në shumën totale prej \_\_\_\_\_ lekë, shumë e cila është e pagueshme në  
(shuma në shifra dhe fjalë)

mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në kontratë.

Ne marrim përsipër të paguajmë, sapo të bëni kërkesën e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëni argumentim të kërkesës, shumën brenda kufirit prej \_\_\_\_\_ Lekë  
(shuma e garancisë në shifra dhe fjalë)

- Me këtë garanci ju sigurojmë se nuk është nevoja t'i drejtoheni me parë Kontraktorit për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj.

- Deklarojmë gjithashtu, se asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të kontratës, për të cilën ju mund të bëni dakord me kontraktorin, nuk na cliron nga detyrimet e kësaj Garancie.

- Kjo garanci është e vlefshme deri në datën që përmbushet afati 30 ditë nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit të Punimeve / Vërtetimi i Realizimit të Kontratës.

Nenshkrimi dhe Vula e Bankes/Shoqerise se Sigurimit  
Shtojca 14

### FORMULARI I ANKESËS

Data: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_.

Ankesë drejtuar: \_\_\_\_\_

(institucioni që zhvillon konkurrimin publik / ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore)

Ankuesi: \_\_\_\_\_

*(Ankuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, një bashkim shoqëror).*

Adresa: \_\_\_\_\_

Të dhëna të kontaktit: \_\_\_\_\_

*(email dhe nr. Telefoni)*

Personi i Kontaktit: \_\_\_\_\_

Objekti i procedurës së Konkurrimit publik: \_\_\_\_\_

Institucioni që zhvillon konkurrimin publik: \_\_\_\_\_

Përshkrimi i ankesës: \_\_\_\_\_

Baza ligjore e ankesës: \_\_\_\_\_

Argumentat dhe arsytimit: \_\_\_\_\_

*(Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumentave të konkurrimit, nëse zbatohen)*

*Që një ankesë të konsiderohet e plotë ajo duhet të jetë e plotësuar saktë sipas këtij formulari. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e konkurrimit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shtojca 15

FORMULARI I NJOFTIMIT TË ANULLIMIT

Data: \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

Emri dhe adresa e institucionit që zhvillon konkurrimin publik:

Emri

Adresa

Tel

E-mail

Faqja në Internet

Objekti i procedurës së Konkurrimit publik : \_\_\_\_\_

Publikuar në datë \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. \_\_\_\_\_ datë  
\_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

Fondi limit \_\_\_\_\_

Arsyet e Anulimit: \_\_\_\_\_

Informacione shtesë

\_\_\_\_\_

Nënshkrimi i Titullarit të institucionit

Vula

Shtojca 16

DEKLARATA E DISPONUESHMËRISË SË MAKINERIVE

(për punimet e ndërhyrjeve ruajtëse)

Ofertuesi: \_\_\_\_\_

Deklaroj se zotëroj mjetet / pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: \_\_\_\_\_ si vijon:

Në pronësi

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. i shasisë	Të tjera	

Me qera

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. i shasisë	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)

Autorizojmë institucionin/autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

Ofertuesi /ose person i autorizuar

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 17

FORMULAR VLERËSIMI  
(për punimet e ndërhyrjeve ruajtëse dhe/ose te ngjashme )  
( Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti kontraktor/Investitori

Adresa/Tel.

Emri i Titullarit/Administratorit

VËRTETOJ SE:

Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën: \_\_\_\_\_

Emri i operatorit NIPT/

Bashkimit të operatorëve NIPTE-T:

Nënkontraktoret NIPTET:

Adresa/t

Objekti i kontratës së lidhur:

Data e fillimit të kontratës

\_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

Vlera sipas kontratës

\_\_\_\_\_

Data e mbarimit të kontratës

\_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

Vlera e realizuar

\_\_\_\_\_

% e bashkimit te O.E. dhe përshkrimi  
i punëve të kryera nga secili anëtar

\_\_\_\_\_

Nënkontraktoret: \_\_\_\_\_

Vlerësimi

(shprehur me fjalë)

E përmbushur

E papërmbushur

Nënshkrimi i Autoritetit Kontraktor/investitori

Vula

## II. UDHËZIME PËR OFERTUESIT

### I. TË PËRGJITHSHME

1. Me paraqitjen e ofertes, ofertuesi pranon në mënyrë të plotë të gjitha afatet dhe kushtet e dokumentave të konkurrimit dhe heq dorë nga kushtet e zbatimit të vetë ofertuesit. Çdo klauzolë në ofertë në kundërshtim me këtë parashikim nuk do të vlerësohet ose do të çojë në refuzimin e ofertës.
2. Ofertuesit duhet të shqyrtojnë me kujdes dhe të respektojnë të gjitha udhëzimet, format, kushtet, specifikimet dhe kërkesat e përfshira në dokumentat e konkurrimit. Në rast të ndonjë mosperputhje midis ose ndërmjet pjesëve të dokumentave të konkurrimit, ofertuesit duhet të kërkojnë sqarim nga institucioni publik/autoriteti kontraktor.
3. Dorëzimi i ofertës pas afatit të caktuar për dorëzimin e ofertave, do të rezultojë në refuzimin e ofertës.
4. Mosdhënia brenda afatit të gjithë informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar do të rezultojë në refuzimin e Ofertes.
5. Veprimet e Jashteligjshme - Institucioni publik do të refuzojë një ofertë, në rast se kandidati që e bën atë jep ose premtion të japë drejtperdrejtë ose terthorazi, çdo zyrtari të tanishëm apo të mëparshëm ose nëpunësit të institucionit publik apo organeve të tjera, një shpërblim në çfarëdo forme, një punësim ose çdo shërbim apo vlefhtë, si stimul për një akt, vendim ose procedurë që do të ndërmarrë institucioni publik lidhur me procedurat e konkurrimit.
6. Ofertuesi nuk duhet të ketë konflikt interesi. Çdo ofertues që zbulohet të ketë konflikt interesi do të skualifikohet. Një ofertues mund të konsiderohet të ketë konflikt interesi me një ose më shumë palë të konkurrimit edhe nëse ofertuesi:
  - Dorëzon më tepër se një oferte në këtë konkurrim, me përjashtim të ofertave alternative, nëse kërkohen;
  - Është i lidhur me një person fizik ose juridik, i ngarkuar nga institucioni publik të sigurojë shërbimë këshilluese për përgatitjen e skicimit, specifikimeve dhe dokumenteve të tjerë që do të përdoren në këtë konkurrim.
7. Anëtarët e Njësisë së vlerësimit të ofertave nuk duhet të kenë lidhje pune, gjaku ose interesash me asnjë ofertues. Për këtë arsye, anëtarët e njësisë duhet të nënshkruajnë deklaratën përkatëse përpara hapjes së ofertave.
8. Kualifikimi i Ofertave - Një person fizik apo juridik do të skualifikohet nga procedura e konkurimit në se ai nuk plotëson Kërkesat per Kualifikim dhe nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar si provë të kualifikimeve të tij të përcaktuara në dokumentet e konkurrimit.

Kërkesat e kualifikimit do të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë kandidatët.

9. Njësia e vlerësimit të ofertave duhet të skualifikojë një ofertues, nëse konstaton në çdo kohë deri në nënshkrimin e kontratës, që informacionet e paraqitura lidhur me kualifikimin ose të dhënat që kanë lidhje me vlerësimin, janë të pasakta, të rreme ose jo të plota.

10. Një bashkim i përkohshëm subjektsh/operatorësh ekonomikë mund të marrë pjesë në konkurrim nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

- Dorëzon një aktmarrëveshje të noterizuar, midis operatorëve ekonomikë (persona fizikë ose juridikë) të bashkimit të përkohshëm e firmosur nga të gjithë anëtarët, përpara afatit të fundit të paraqitjes së ofertave. Aktmarrëveshja duhet të përcaktojë minimalisht, në mënyrë të qartë detyrimet e secilit anëtar veç e veç dhe bashkërisht për përmbajtjen e ofertës deri në zbatimin e kontratës në rast se shpallen fitues.

- Oferta firmoset nga një përfaqësues i bashkimit të përkohshëm që është autorizuar shprehimisht me shkrim nga të gjithë anëtarët e këtij bashkimi. Çdo anëtar i bashkimit të përkohshëm duhet të plotësojë kërkesat e kualifikimit të konkurrimin dhe duhet të paraqesë të gjitha dokumentet e kërkuara administrative dhe ligjore.

12. Vizita në objekt: Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të parashikojë një vizitë të organizuar në objekt me kandidatët e interesuar për të marrë pjesë në konkurrim. Çdo operator ekonomik/kandidat pjesëmarrës në këtë vizitë, përballon vetë shpenzimet.

## II. MBI VEPRIMET PROCEDURIALE

1. Sqarimi i Dokumentave të konkurrimin dhe modifikimi - Një kandidat që kërkon sqarime mbi dokumentat e konkurrimin duhet të bëjë kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit të konkurrimin, jo më vonë se 5 ditë para përmbushjes së afatit të hapjes së ofertave.

Komisioni i konkurrimin do t'i përgjigjet me shkrim kërkesës për sqarime, brenda 2 ditëve nga regjistrimi/depozitimi i kërkesës. Kopje me shkrim të përgjigjes do t'i dërgohet të gjithë subjekteve që kanë kërkuar dokumentat e konkurrimin/kanë shprehur interes për pjesëmarrje.

Komisioni i konkurrimin, në çdo kohë, por jo më vonë se 5 ditë përpara mbarimit të afatit të paraqitjes së ofertave, me iniciativën e tij ose në përgjigje të një kërkesë nga një subjekt i interesuar, mund t'i ndryshojë dokumentet e konkurrimin, duke e dokumentuar këtë ndryshim me një shtojcë, e cila bëhet pjesë përbërëse e dokumenteve të konkurrimin dhe iu njoftohet subjekteve që kanë kërkuar dokumentat e konkurrimin/ kanë shprehur interes për pjesëmarrje.

Nëse Komisioni i konkurrimin e konstaton të nevojshme të ndryshojë dokumentat e konkurrimin, dhe kjo ndodh më vonë se 5 ditë përpara mbarimit të afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, mund të vendosë të shtyjë datën e zhvillimit të konkurrimin publik me jo më shumë se 5 ditë nga data e publikuar në fillim.

Njoftimi në këtë rast publikohet vetëm në Buletinin e Njoftimeve Publike.

### 2. Përgatitja e ofertave

- Oferta do të shkruhet në gjuhën e përcaktuar në të dhënat e dokumentave të konkurrimit.
- Çmimet të shprehen në monedhën e përcaktuar në të dhënat e dokumentave të konkurrimit. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme, për efekt krahasimi ofertash, do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi publik për konkurrimin në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
- Oferta ekonomike do të përfshijë dokumentat e mëposhtme:
  - a. Formularin e Ofertës të firmosur nga ofertuesi, të futur në një zarf, siç përcaktohet në të dhënat e dokumentave të konkurrimit. Ky formular duhet të plotësohet në të gjitha vendet bosh, pa ndryshuar formatin.
  - b. Formularin e Preventivit i plotësuar me çmime, sipas zërave dhe bashkëngjitur me Ofertën, siç përcaktohet në të dhënat e dokumentave të konkurrimit;
  - c. Sigurimin e ofertës;
  - d. Listën e të gjithë dokumentave ligjorë/administrativë të kërkuar në dokumentat të konkurrimit.

3. Specifikimet teknike do të përfshijnë dokumentat e mëposhtme:

- Grafikon e realizimit të punimeve për ndërhyrjet ruajtëse
- Deklarate për përbërjen e stafit të specializuar, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor
- Plan organizimi i punimeve (në rastin e zbatimit të punimeve)

Si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të vlerësuar nga Autoriteti Kontraktor.

4. Informacion për çmimin - Ofertuesi duhet të sigurojë një përshkrim të shkurtër të punimeve sipas objektit të kontratës, që do të kryhen dhe shërbimeve në lidhje me to.

Të gjitha çmimet / vlerat e ofruara duhet të jenë të sakta, pa gabime aritmetike dhe jo subjekt rishikimi.

Të gjitha çmimet e ofruara duhet të jenë bazuar në çmimin e preventivit për njësi (për kontratat për kryerjen e punimeve) të paraqitura nga ofertuesi.

Ofertuesi duhet të plotësojë çmimet dhe tarifatat për të gjitha zërat e punimeve të përshkruara në preventiv.

Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Çmimin Total të Ofertes, pa TVSH
- b. Çdo informacion tjetër të kërkuar në dokumentat e konkurrimit

5. Kërkesat e detajuara për Punimet objekt kontrate dhe shërbimet në lidhje me to shprehen në dokumentat e konkurrimit.

Kur në dokumentat e konkurrimit kërkohen, planimetritë, skicimet, literatura përshkruese, udhëzimet, manualët, katalogët, broshurat ose fletëpalosjet për materialet dhe Punimet e ofruara, këto duhet të shoqërojnë ofertën. Duhet të jenë në gjuhën e shprehur në dokumentat e konkurrimit dhe mund të kërkohen edhe në formë elektronike.

6. Periudha e vlefshmërisë së ofertave - Pas kalimit të afatit për paraqitjen e ofertave, ofertat do të mbeten të vlefshme dhe në fuqi për ofertuesin për kohën e specifikuar në dokumentat e konkurrimit. Nëse në ofertë ofertuesi shprehet se është e vlefshme për një periudhë kohe më të shkurtër ajo duhet të refuzohet.

Përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë, Komisioni i konkurrimit publik, në raste të veçanta kur ka ndryshime që ndikojnë në afatet kohore, mund t'i kërkojë me shkrim ofertuesve të zgjasin afatin e vlefshmërisë. Ofertuesi që refuzon kërkesën nuk e humbet sigurimin e ofertës. Ofertuesi që e pranon kërkesën nuk do t'i kërkohet ose lejohet të tërheqë ofertën e tij gjatë periudhës së zgjatjes së vlefshmërisë, pa humbur më parë sigurimin e ofertës.

Gjatë kësaj periudhe nuk lejohet absolutisht ndryshimi i ofertave.

7. Sigurimi i ofertës - Kërkesat për shumën dhe formën e sigurimit të ofertës tregohen në të dhënat e dokumentave të konkurrimit.

Sigurimi i ofertës duhet të paraqitet me ofertën ekonomike dhe ka për qëllim të sigurojë Autoritetin Kontraktor lidhur me përgjegjshmërinë e ofertuesit.

Me përjashtim të rastit kur konfiskohet sigurimi i ofertës, ajo do t'i kthehet ofertuesit që e ka depozituar atë, brenda 5 ditëve, në rastet kur:

- të gjitha ofertat refuzohen;
- kur procedura e konkurrimit anulohet nga institucioni publik;
- kur ofertuesi skualifikohet ose oferta është refuzuar;
- Kur ka hyrë në fuqi kontrata.

Sigurimi i ofertës do të konfiskohet nga institucioni publik nëse ofertuesi tërheq ofertën e tij brenda periudhës së vlefshmërisë.

Sigurimi i Ofertës do të konfiskohet nëse oferta refuzohet për veprime të paligjshme të përshkruara në Klauzolën e mësipërme të udhëzimeve.

Sigurimi i Ofertes do të konfiskohet nëse ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik në ofertën e tij të zbuluar gjatë vlerësimit të ofertës.

Ofertuesit fitues do t'i konfiskohet sigurimi i ofertës nëse ofertuesi heq dorë nga lidhja e kontratës ose nuk është në gjendje të japë sigurimin e kontratës.

8. Formati dhe nënshkrimi i ofertës - Ofertuesi duhet të paraqesë vetëm një zarf me dokumentat origjinale ose kopje të noterizuara të tyre, për të marrë pjesë në konkurrimin publik.

Oferta duhet të nënshkruhet nga ofertuesi ose nga një person i autorizuar për të firmosur në emër të ofertuesit. Prova e autorizimit konsiston në autorizimin me shkrim dhe i bashkëngjitet ofertës.

Të gjitha faqet e Ofertës, duhet të nënshkruhen nga personi që firmos ofertën.

9. Paraqitja e ofertave - Ofertuesit duhet të dërgojnë ofertat e tyre në afatin, vendin, dhe mënyrën e dërgimit të shprehur në njoftimin publik dhe dokumentat e konkurrimit.

Ofertat e depozituara me postë pas afatit të përcaktuar në Ftesën për ofertë, nuk do të hapen dhe do të refuzohen. Me kërkesë me shkrim të ofertuesit, ato mund të tërhiqen pranë zyrës së protokoll arshivës të Autoritetit Kontraktor, brenda një afati prej 10 ditësh, me një procesverbal midis palëve. Në të kundërt ato do të asgjësohen.

Çdo ofertues mund të paraqesë vetëm një ofertë, në rast të kundërt ai do të skualifikohet dhe do të refuzohen të gjitha ofertat ku ka marrë pjesë ofertuesi.

Paraqitja nga një ofertues e më shumë se një oferte ose pjesëmarrja e tij në më shumë se një bashkim operatorësh direkt apo indirekt, do të përbejë shkak për skualifikimin e tij, si dhe refuzimin e të gjitha ofertave ku mund të ketë marrë pjesë ose është përfshirë ofertuesi.

10. Paraqitja e ofertës - Oferta do të futet në një zarf/kuti të mbyllur dhe të firmosur e vulosur nga ofertuesi.

Brenda tij në një zarf të veçantë dhe të mbyllur, futet oferta ekonomike e firmosur dhe vulosur.

Mënyra e paraqitjes së tyre, mbishkrimet e duhura përcaktohen në dokumentet e konkurrimit, ku të evidentohet gjithashtu shënimi: “Të mos hapet para datës së hapjes së ofertes.”

11. Hapja e ofertave - Njësia e vlerësimit të ofertave do të hapë të gjitha ofertat në datën dhe orën e përcaktuar në Dokumentat e konkurrimit.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar do të lejohen të ndjekin hapjen e ofertave.

Ofertat do të hapen dhe informacioni që duhet të njoftohet, është si më poshtë vijon:

- Emri i ofertuesit;
- Shuma totale e ofertës;
- Prezenca ose mungesa e sigurimit të ofertës;

Do të mbahet procesverbali dhe në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi do t’i vihet në dispozicion një kopje e këtij procesverbal.

12. Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave - Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave do të bëhet pas kualifikimit ligjor dhe në bazë të kriterit të vlerësimit për çmimin më të ulët.

Konfidencialiteti - Pas hapjes së ofertes, informacioni që ka të bëjë me shqyrtimin, sqarimin dhe vlerësimin e ofertave, nuk duhet t’i transmetohen ofertuesve ose personave të tjerë që nuk kanë lidhje zyrtare me procesin deri kur fituesi i kontratës të shpallet publikisht.

Pas hapjes së ofertes dhe deri sa të firmoset kontrata, asnjë ofertues nuk duhet të komunikojë pa kërkesë me shkrim, me institucionin publik ose të përpiqet në ndonjë mënyrë të influencojë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave nga Njësia e vlerësimit.

Çdo përpjekje nga ofertuesi për të influencuar komisionin e konkurrimit në vendimin mbi vlerësimin e ofertës, krahasimin e ofertës, ose dhënien e kontratës, mund të rezultojë në refuzimin e ofertës së atij ofertuesi.

13. Shqyrtimi paraprak i ofertave - Njësia e vlerësimit të ofertave do të shqyrtojë çdo ofertë për të verifikuar nëse është paraqitur i gjithë dokumentacioni i kërkuar në dokumentat e konkurrimit.

Nëse ndonjë prej dokumentave të kërkuar mungon ose është i paplotë, oferta do të refuzohet.

14. Shqyrtimi i afateve dhe kushteve dhe vlerësimi teknik i ofertave - Njësia e vlerësimit të ofertave do të shqyrtojë çdo ofertë nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentat e konkurrimit. Oferta që është dorëzuar në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, konsiderohet e vlefshme.

Oferta është e vlefshme edhe nëse përmban devijime të vogla që nuk alternojnë materialisht ose dalin jashtë karakteristikave, afateve, kushteve dhe kërkesave të tjera të përcaktuara në dokumentat e konkurrimit.

Oferta që nuk është e vlefshme do të refuzohet.

Njësia e vlerësimit të ofertave do të vlerësojë dhe krahasojë ofertat që janë kualifikuar si të vlefshme me qëllim që të përcaktojë ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriterin e paraqitur në dokumentat e konkurrimit.

Oferta fituese do të jetë oferta e vlefshme e kualifikuar me vlerën më të ulët ekonomike.

15. Njësia e vlerësimit të ofertave mund t'i kërkojë një ofertuesi të japë sqarime me shkrim për ndonjë paqartësi të Ofertes të tij.

Nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim ose në substancën e Ofertes përveçse korrigjimit të gabimeve aritmetike, jo më shumë se në vlerën e përcaktuar në këto dokumenta.

Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e evidentuar, apo nuk i përgjigjet kërkesës së Autoriteti Kontraktor, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës. Afati për kthimin e përgjigjes mbi sqarimin e kërkuar apo pranimin e korrigjimit është brenda 2 ditëve nga njoftimi.

Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen, si më poshtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total;

- nëse ka një gabim në një shumë totale, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigohet.

Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se +/- 2% e vlerës së ofertës ekonomike të paraqitur.

Nëse oferta/ofertat e dorëzuara, rezultojnë anomalisht e ulët në lidhje me punimet e objekt kontrate të ofruara, atëherë Njësia e vlerësimit i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë/analizojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës dhe bindës për Njësinë, atëherë kjo e fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 40 % e fondit limit të përlllogaritur.
- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 50 % e mesatares së ofertave të vlefshme.

16. Nëse renditen të para më shumë se një ofertë e vlefshme me të njëjtën vlerë, njësia e vlerësimit vendos me short, për ofertën fituese, në praninë e ofertuesve që janë renditur të parët me vlera të njëjta. Vendimi i Njesisë së Vlerësimit është përfundimtar dhe duhet të jetë i argumentuar. Ofertuesve duhet t'i caktohet një afat prej jo më pak se 1 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit për t'u praqitur për hedhjen e shortit dhe ky afat nuk duhet të përkojë në ditë pushimi zyrtar. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit, nuk përbën shkak për skualifikim nga procedura e konkurrimit.

17. Pas hapjes së ofertave Komisioni i Konkurrimit publik anulon procedurën në rastet si vijon:

- Nuk është paraqitur asnjë ofertë;
- Nuk është kualifikuar asnjë ofertë e vlefshme;
- Kur ofertuesi/ofertuesit e kualifikuar tërhiqen para lidhjes së kontratës ose nuk pranojnë të bëjnë sigurimin e kontratës;
- Kur ka një vendim me pasojë anulimin nga organi epror që ka shqyrtuar ankesën;
- Për arsye dhe shkaqe që nuk varen nga vullneti i institucionit / autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës.

18. Oferta fituese - Oferta fituese është oferta e cila plotëson të gjitha kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dokumentat e konkurrimit dhe që është përcaktuar si fituese në bazë të kriterit të vlerësimit për çmimin më të ulët.

19. Shpallja e fituesit dhe nënshkrimi i kontratës

- a. Njësia e vlerësimit të ofertave do të njoftojë ofertuesin Fitues se oferta e tij është pranuar dhe vlerësuar fituese.
- b. Njoftimi do të përmbajë të paktën vlerën e ofertës, dhe kërkesën për dhënien e sigurimit të

- kontratës, brenda një afati të përcaktuar.
- c. Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me anë të nënshkrimit të kontratës, duke bashkëlidhur si anekse të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, brenda afatit të përcaktuar nga marrja e njoftimit të fituesit.
  - d. Nëse ofertuesi i shpallur fitues nuk e pranon nënshkrimin e kontratës dhe nuk depoziton brenda afatit kohor të përcaktuar në dokumentat e konkurrimit, apo në njoftimin e fituesit, sigurimin e kontratës në masën 10% të vlerës së saj, institucioni publik bën konfiskimin e sigurimit të ofertës, dhe vijon me shpalljen si fitues të pjesëmarrësit i renditur i dyti në klasifikim, e me radhë. Nëse është kualifikuar vetëm një ofertë e vlefshme, atëherë procedura anulohet.

20. Sigurimi i kontratës - Institucioni publik do të kërkojë dhënien e sigurimit të kontratës nga ofertuesi fitues në shumën dhe formën e parashikuar në dokumentat e konkurrimit.

Ofertuesi fitues duhet të japë garancinë e sigurimit të kontratës brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e fituesit

Nëse ofertuesi fitues dështon në dhënien e sigurimit të kontratës brenda afatit, ofertuesi humbet të drejtën e tij për të nënshkruar kontratën dhe i konfiskohet sigurimi i ofertës.

21. Llogaritja e limiteve kohore - Të gjitha referencat për ditët do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Periodhat dhe limitet kohore do të fillojnë të numërohen nga fillimi i ditës pas datës së aktit ose veprimit që shërben si pikënisje për periodhat ose limitet kohore.

Aty ku një periudhë ose limit kohor shprehet në ditë, ai do të skadojë në fund të ditës së fundit të periudhës ose limitit kohor.

Aty ku dita e fundit e një periudhe ose limiti kohe bie në ditë feste në Republikën e Shqipërisë, periudha ose limiti kohor do të zgjatet deri në fund të ditës tjetër të punës.

22. Shqyrtimi administrativ - Ofertuesi ka të drejtë të kërkojë shqyrtim administrativ të një veprimi ose neglizhence nga institucioni publik, të cilin ofertuesi e konsideron një shkelje të dispozitave VKM nr. 425/2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar, të Konkurrimit Publik, të Rregullave apo dhe çdo udhezimi të lëshuar për to. Paraqitja e ankesës tek titullari i institucionit publik ose te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pezullon shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës deri në kthimin e përgjigjes sipas kompetencave dhe afateve të parashikuara në dokumentat e konkurrimit. Pasi institucioni publik të ketë nënshkruar kontratën me ofertuesin e shpallur fitues, asnjë ankesë ndaj një veprimi ose neglizhence në proces që ka çuar në atë fazë, nuk mund të shqyrtohet me anë të një hetimi administrativ.

Procedurat dhe afatet e ankimimit përcaktohen në VKM nr. 425/2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar.

### III. KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATËS PER KRYERJEN E PUNIMEVE PER NDERHYRJET E DETYRUARA RUAJTESE

#### Neni 1: Zbatimi i kuadrit ligjor

1. Kjo kontratë është hartuar në bazë të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, vendimit nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar dhe dispozitat e Kodit Civil të RSH, për kontratat.

#### Neni 2. Përkufizime

1. “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Institucionit publik dhe Kontraktorit dhe përbëhet nga dokumentat e konkurrimit publik duke përfshirë të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti standart.
2. “Institucioni publik” do të thotë institucioni /autoriteti kontraktor që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate kërkon realizimin e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse.
3. “Kontraktori” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron zbatimin e kontratës për realizimin e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse.
4. “Objekti i kontratës” do të thotë të gjitha punimet për ndërhyrjet ruajtëse që Kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës, ku përfshihet cdo shërbim/ndërhyrje që bëhet në pasurinë kulturore, me qëllim mirëmbajtjen e tij dhe përmirësimin e gjendjes së tij fizike.
5. “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore sipas kushteve të rëna dakort.
6. “Preventiv punimesh” do të thotë volumet e punës të dhëna në projekt, shoqëruar me çmimet për njësi të pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime me matje.
7. “Preventiv total” do të thotë volumet e punes të dhëna në projekt të cilat janë orientuese, plotësuar me çmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertës në një kontratë me çelsa ne dore.
8. “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
9. “Data e fillimit” është data kur kontraktori do të fillojë punimet për ndërhyrjet ruajtëse.
10. “Data e realizimit të kontratës” do të thotë data që Punimet e zbatimit duhet të përfundojnë, siç është shprehur në Grafikon e realizimit të punimeve për ndërhyrjet ruajtëse.
11. “Realizimi i kontratës” do të thotë Akti administrativ, me anë të cilit autoriteti kontraktor vërteton se punimet e ndërhyrjeve ruajtëse janë realizuar/përfunduar nga Subjekti i Kontraktuar, në përputhje me termat e referencës/projektin e miratuar nga KKTKM.
12. “Drejtues projekti” do të thotë personi i autorizuar për mbikëqyrjen e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse, sipas legjislacionit ne fuqi
13. “Standarde teknike të ndërhyrjes” do të thotë specifikimet dhe kriteret e ndërhyrjes, të aprovuara dhe të miratuara në dokumentat e konkurrimit, të tilla që i referohen dispozitave, parimeve, rregullave dhe udhëzimeve të përcaktuara në aktet nënligjore për mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore .
14. “Nënkontaktues” do të thotë çdo person fizik ose juridik privat, që furnizon materialet ose pajisjet për ose në emër të Kontraktorit.

### **Neni 3: Nënshkrimi i Kontratës**

1. Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për nënshkrimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e konkurrimit publik.
2. Kontrata do të nënshkruhet nga palët duke bashkëngjitur, por pa u kufizuar:
  - a) njoftimin e fituesit;
  - b) formularin e sigurimit të kontratës;
  - c) formularin e ofertës fituese;
  - d) dhe/ose çdomarrveshje e rënë dakort midis palëve;
  - e) projektin.

### **Neni 4: Sigurimi i Kontratës**

1. Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.
2. Sigurimi i kontratës në shumën prej 10% të vlerës së Kontratës duhet të ofrohet nga Kontraktori si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktorit në plotësimin e ekzekutimit të detyrimeve të tij sipas kontratës, ashtu siç përcaktohet në dokumentat e konkurrimit publik.
3. Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, Kontraktorit 30 ditë pas marrjes në dorëzim të objektit/pas përfundimit të punimeve. Në rastin e kryerjes së ndërhyrjeve të detyrura ruajtëse, 5 % e vlerës së Kontratës do të ngurtësohet para marrjes në dorëzim të veprës dhe do t'i çngurtësohet subjektit kontraktor pas 12 muajve nga lëshimi i certifikatës së pranimit të punimeve.
4. Sigurimi i kontratës mund të bëhet edhe nëpërmjet shoqërive të sigurimit. Në këtë rast, shoqëria e sigurimit nëpërmjet sigurimit të kontratës mbulon çdo dëmtim të interesave të institucionit nga subjekti kontraktor, gjatë zbatimit të kontratës.

### **Neni 5: Drejtuesi i projektit**

1. Drejtuesi i projektit është Mbikqyrësi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse i autorizuar me shkrim nga institucioni që zhvillon procedurën/autoriteti kontraktor ose personi i ngarkuar nga institucioni për ndjekjen e zbatimit të kontratës.
2. Autorizimi me shkrim është dokument që i bashkëlidhet kontratës.
3. Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis Kontraktorit dhe Institucionit publik. Për çdo çështje, Drejtuesi mban korrespondencë me shkrim, të cilat i bashkëngjiten kontratës gjatë zbatimit të saj.
4. Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët, përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë Kontraktorin, për delegimet e bëra dhe ato të anuluar.

### **Neni 6: Inspektimet dhe Testimet**

1. Inspektimet dhe testimet përpara dhe pas lëshimit të vërtetimit të mbarimit të punimeve do të përfshijnë: Punimet e ndërhyrjeve ruajtëse të kryera sipas projektit të kërkuar dhe miratuar.
2. Testimet dhe inspektimi përfundimtar firmoset patjetër nga Mbikëqyrësi i autorizuar, Drejtuesi i Institucionit, dhe nga Kontraktori/përfaqësuesi i autorizuar i subjektit kontraktor që kryen punimet.
3. Me shpenzimet e tij, Institucioni publik ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.

Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të Kontraktorit, Kontraktori duhet të marrë leje për Institucionin publik, që të ndjekë këto testime dhe inspektime.

4. Institucioni publik gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë, por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Institucioni publik do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktorit, Institucioni publik do të bjerë dakord të ndryshojë grafikun.
5. Institucioni publik do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
6. As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë Kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

#### **Neni 7: Lloji dhe çmimi i Kontratës**

1. Çmimi total i Kontratës do të përbëhet nga totali i ofertës, e specifikuar sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

#### **Neni 8: Grafiku i pagesës**

Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm dhe në bazë të situacioneve:

1. Me paraqitjen e situacionit, subjektit kontraktor i bëhet pagesa sipas situacioneve të paraqitura në 3 (tri) kopje. Situacionet nënshkruhen nga mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi i ngarkuar i shoqërisë dhe drejtuesi i institucionit që ka lidhur kontratën ose nga personi i autorizuar prej tij.
2. Pagesa e çdo situacioni do të bëhet, brenda 20 ditëve, nga paraqitja e situacionit/ëve të firmosura/konfirmuara nga personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në zyrën e financës së institucionit që ka lidhur kontratën.
3. Monedha e pagesës do të jetë në monedhën Shqiptare - Lekë.

#### **Neni 9: Pagesa paraprake**

1. Kontraktori do të marrë pagesë paraprake vetëm nëse palët e parashikojnë në kontratën e lidhur midis tyre një gjë të tillë.
2. Nëse është parashikuar një pagesë paraprake, përqindja e pagesës paraprake do të jetë 10% e vlerës totale të kontratës, dhe do t'i paguhet Subjektit Kontraktor brenda 10 ditëve nga lidhja e kontratës midis palëve.

Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktorit sipas formulës së mëposhtme:

- 10% e Situacionit të paraqitur, nënshkruar e pranuar nga palët, siç parashikohet në grafikun e realizimit të punimeve të restaurimit.

#### **Neni 10: Praktikët e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

1. Institucioni publik mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit.
2. Kontraktori duhet të lejojë Institucionin publik të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Institucioni publik.

### **Neni 11: Informacioni Konfidencial**

1. Kontraktori dhe Institucioni publik duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
2. Kontraktori mund t'i japë nën-Kontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Institucioni publik deri në masën e kërkuar që nën-Kontraktori të zbatojë vetëm punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 1 më sipër.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i paraqesë Institucionit publik të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Institucioni publik.

### **Neni 12: Kontrolli paraprak i materialeve që përdoren për punimet e ndërhyrjeve ruajtëse**

1. Në çdo rast Mbikqyrësi i punimeve ka për detyrë të kontrollojë materialet që subjekti Kontraktor do të përdorë, të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në dokumentat standarte të konkurrimit si dhe në ofertën e kontraktorit.
2. Në rast të konstatimit në kundërshtim me paragrafin 1, mbikqyrësi ndërpret punimet, vë në dijeni Drejtuesin e institucionit publik dhe detyron subjektin Kontraktor të zbatojë kushtet e kontratës.
3. Në rast se përdorimi i materialeve jo të duhura është konstatuar pas punimeve, atëherë subjekti kontraktor njoftohet për kompesimin e dëmit të shkaktuar pasurisë kulturore, sipas sanksioneve të vendosura në kontratë.

### **Neni 13: Komunikimi**

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim. Data e njoftimit do të quhet data e marrjes dijeni të njoftimit, të konfirmuar respektivisht nga palët ose përfaqësuesit e tyre.

### **Neni 14: Mbarimi i Punimeve për ndërhyrjet ruajtëse**

1. Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit dhe duhet t'i mbarojë brenda Datës së Mbarimit.
2. Palët mund të vendosin me marrëveshje, të nënshkruar nga të dy palët, për shtyrjen e afatit të mbarimit të kontratës, vetëm nëse:
  - a) Kjo është e argumentuar dhe i shërben cilësisë dhe garantimit të qëndrueshmërisë së pasurisë kulturore;
  - b) Për shkak të forcave madhore të cilat pengojnë në mënyrë direkte përfundimin e kontratës.

### **Neni 15: Detyrimi për mbrojtjen dhe sigurinë e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse dhe zonës së mbrojtur të pasurisë kulturore**

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në pasurinë kulturore dhe zonën e mbrojtur përreth sipas dispozitave të ligjit "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

### **16: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, punime publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit të punimeve.

### **Neni 17: Zbulimet**

Çdo objekt me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në zonën e mbrojtur të pasurisë kulturore ose në truallin nën të, bëhet pronë e Institucionit publik. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën, sipas dispozitave të ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Për këtë duhet të mbahet procesverbal i cili nënshkruhet ngë palët.

### **Neni 18: Kontrolli i cilësisë**

1. Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollimin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
2. Sapo të lidhë kontratën, Kontraktori duhet t’i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.
3. Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e Kontraktorit dhe të njoftojë Kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur. Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, Kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda kohëzgjatjes së parashikuar në njoftim.
4. Nëse Kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin e defektit nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë Kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet.
5. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën bazë për ndërprerje e kontratës për mosplotësim, sipas të drejtës së Institucionit publik.

### **Neni 19: Garancitë**

1. Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punimet e ndërhyrjeve ruajtëse janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar nga institucioni publik në dokumentat standarte të konkurrimit dhe trupëzojnë përmirësimet e pasurisë kulturore.
2. Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë ose nga ligji, Kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i Kontraktorit ose të shkaktuara nga skicimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, në kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

### **Neni 20: Çmimi i kontratës**

Çmimet/vlera e Kontraktorit për punimet e ndërhyrjeve ruajtëse sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga Kontraktori në ofertën e tij.

### **Neni 21: Kushtet e pagesës**

1. Vlera e kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në këtë kontratë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër të kontratës, pagesa do të bëhet me monedhën Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi publik për

konkurrimin në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

3. Kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë/relacion me situacionin e punimeve nga drejtuesi i projektit që vërteton se rezultati për atë fazë punimi është arritur. Deklarata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar, duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.
4. Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga Kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet Kontraktorit brenda 20 ditëve pune nga data që Kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
5. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet me një dispozitë tjetër të kontratës, pagesa e progresit për punimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data që progresi është verifikuar nga drejtuesi i projektit.
6. Data e pagesës do të jetë dita që fondet preken nga llogaria e Institucionit publik.

#### **Neni 22: Vonesa në bërjen e pagesës**

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktori ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

#### **Neni 23: Prona Intelektuale**

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
3. Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
4. Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 24: Nryshimi i ligjeve dhe rregulloreve**

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të

rregullohen në atë masë sa Kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

#### **Neni 25: Forca madhore**

1. Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.
2. Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
3. Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

#### **Neni 26: Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit**

1. Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
2. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit të Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
4. Autoriteti Kontraktor do të jetë dakord për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.
5. Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Autoritetin Kontraktor, për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

#### **Neni 27: Likuidimi i dëmeve për vonesën në realizimin e kontratës**

1. Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktori.
2. Dëmet e likuiduara për vonesën në realizimin e kontratës do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
  - (i) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë

- do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- (ii) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
  - (iii) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

#### **Neni 28: Negociatat dhe amendamentet**

1. Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktorit.
2. Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktorit dhe Drejtuesi i Institucionit publik.
3. Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

#### **Neni 29: Ndryshimi i porosisë**



1. Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Institucioni publik dhe Kontraktori.
2. Punimet shtesë shtesë mund të porositen me kusht që rritja e vlerës të kontratës të mos i kalojë 25 % të vlerës fillestare të kontratës, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
3. Punimet shtesë duhet të jenë konform çmimeve për njësi, për zëra punimesh të ngjashme të ofruara nga kontraktori në Ofertën ekonomike.
4. Çmime më të larta se ato të ofruara në ofertë nuk aplikohen, me përjashtim të atyre zërave të cilat nuk janë të specifikuar në preventiv-ofertë nga institucioni publik, dhe me kushtin që të arrihet rezultati i pritshëm. Në këtë Drejtuesi i Institucionit Publik miraton shtesën dhe amendimet e porosisë së ndryshuar duhet të trupëzohen në amendamentet e marrëveshjes, të lidhur midis palëve.

#### **Neni 30: Mbarimi dhe marrja përsipër e punimeve**

1. Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se punimet janë mbaruar plotësisht.
2. Nëse drejtuesi i projektit zbulon se punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japë udhëzime me shkrim Kontraktorit që specifikojnë zërat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata e Përfundimit të punimeve.
3. Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në punime, duhet t'i japë Kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata e Përfundimit të punimeve.

#### **Neni 31: Ndërprerja e kontratës**

1. Institucioni publik mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
  - a. Kontraktori dështon në realizimin e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse brenda periudhës së



- specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b. Kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
  2. Institucioni publik duhet t'i japë Kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe afat 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, në të cilin rast ndërprerja do të jetë e menjëhershme.
  3. Nëse Kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj, të gjitha materialet dhe punimeve të realizuara apo punimet e trupëzuara deri në atë moment do të bëhen pronë e Institucionit publik.
  4. Institucioni publik mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë. Për këtë Institucioni publik duhet t'i japë Kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.
  5. Institucioni publik mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik. Për këtë duhet ta njoftojë me shkrim për ndërprerjen, si dhe të paguajë Kontraktorin për të gjitha punimet e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të punimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

### **Neni 32 Transferimi i të drejtave**

Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

### **Neni 33: Nënkontraktimi**

1. Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës Kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.
2. Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Institucionit publik. Kontraktori duhet të njoftojë Institucionin Publik për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe identitetin e nën-Kontraktorit. Institucioni publik duhet të lajmërojë Kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
3. Çdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në konkurrimin publik sipas legjislacionit në fuqi.
4. Kur kontraktori ka ndërmend të realizojë një pjesë të punimeve me nënkontraktor, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të konkurrimit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktorit si dhe për punimet konkrete që do të japë me nënkontraktim.

### **Neni 34: Përfaqësimi i palëve**

1. Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
2. Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
3. Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në

veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqesuesit.

### **Neni 35: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Institucioni publik dhe Kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje, me anë të negociatave direkte. Negocimi duhet të provohet vetëm në bazë të komunikimit me shkrim midis palëve.
2. Nëse palët dështojnë në negociatat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen dhe zgjidhen, sipas përcaktimeve në kontratën midis palëve dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 36: Llogaritja e Afateve**

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

## **KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES PER KRYERJEN E PUNIMEVE PER NDERHYRJET E DETYRUARA RUAJTESE**

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

### **Neni 1 Përkufizime**

- 1.1 Autoriteti \_\_\_\_\_ Kontraktor \_\_\_\_\_ është \_\_\_\_\_
- 1.2 Kontraktuesi është \_\_\_\_\_

### **Neni 2 Sigurimi i kontratës**

- 2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej 10 % të vlerës së ofertës duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: Pas plotësimit të gjithë detyrimeve kontraktore nga ana e operatorit ekonomik. Në rastin e kryerjes së punimeve 5 % e vlerës së kontratës do të mbahet si garanci punimesh.

### **Neni 3 Fillimi i Kontratës**

- 3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më \_\_\_\_\_. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.



#### **Neni 4 Vendndodhja e Punimeve**

4.1 Punimet do të kryhen në: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

#### **Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

#### **Neni 6 Kërkesat e Raportimit**

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm:

#### **Neni 7 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Përgjegjës me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: *100% të vlerës së Kontratës*

#### **Neni 8 Kushtet e Pagesës**

8.1 Paga për Punimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: *5% e vlerës së Kontratës do të mbahet deri në përfundim të afatit të garancisë së punimeve.*  
\_\_\_\_\_

8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

8.3 Monedha e pagesës do të jetë \_\_\_\_\_. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

#### **Neni 9 Paga Paraprake**

9.1 Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

#### **Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës**



10.1 Garancia mbetet e pandryshuar.

### **Neni 11 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar**

10.1 Në kushtet e përgjithshme të kontratës janë përcaktuar rastet e likuidimit të dëmëve për dorëzimin e vonuar.

